

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7865 E diel 28 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Për të përligjur ndërtimin e shtetit tribal të ndërtuar nga idiokratët, ose për të përligjur marrjen e rrogave, duke dëmtuar interesin nacional, ose duke ...

Vijon në faqen 21

Nga LIS BUKUROCA

“Shtet i ri” si përligjeje e shtetit tribal



Opinion

Ditës

Me një shpejtësi rrufe, shpejtësi që lë në hije edhe grabitësit në Rinas, kemi gjetur fajtorin e krizës në të cilën ndodhemi: sistemin! Ngazëllimi me të cilin kemi gjetur ...

Vijon në faqen 22

Nga LUTFI DERVISHI

Sistemi, fajtori “fake” i krizës!



Si u ngjiz plani i “goditjes” në aeroport

## Grabitja e Rinasit, policia mësyr në shtëpinë e “Dajës”, 50-vjeçarit nga Peja

Belinda Balluku: Konsulencë e huaj për Rinasit, verifikim kontratës me kinezët

Ragip Hajdini nga Kosova dyshohet të jetë një prej organizatorëve të grabitjes spektakolare brenda pistës së Rinasit mesditën e 9 prillit. Në këtë përfundim ka dalë grupi hetimor pas analizimit të të gjitha provave të grumbulluara deri në momentin e arrestimit të tij. Në kërkim të Hajdinit ...

Në faqen 6-7

PJESA E DYTE/ QEVERIA U NJEH PRONAREVE TE DREJTEN MBI TRUALLIN

## LEGALIZIMET, PRONESIA E TOKES PER 1 MIJE FAMILJE

Lista me përfituesit në Tiranë dhe në rrethe, llogariten sipërfaqet takuese për secilin pronar. Agjencia e Kadastrës: 300 pronarë ndajnë 105 milionë lekë



(Në foto) Ndërtime informale

Në faqen 10-12

TAKIMI NE ELBASAN

Rama: Zgjedhjet më 30 qershor, fitojmë në të gjitha bashkitë

Në faqen 3

PARTIA E PATOZIT

KQZ regjistron me debate ‘Bindjen Demokratike’, në zgjedhje 42 parti

Në faqen 2

KRYETARI I PD

Basha prezanton programin për shëndetësinë: Do të anulohet PPP-të

Në faqen 4

PJESA E TRETË

Dr. Hasan Luçi: Si u krijua më 1914 qeveria e përkohshme vorioepirote

Në faqen 8-9

SHENJAT E GISHTAVE



Vrasja e vëllezërve Bilali në Shkodër, bashkëpunëtorët u zbuluan nga gjurmët

Në faqen 5

Përfundon projektimi arkitekturor, ja plani i ndërtesës 3-katëshe

## Si do të jetë muzeu i kulturës françeskane?

Në brendësi: Mehmet Elezi, Myslim Pasha, Faslli Haliti, Ben Andoni

NGA GJON RADOVANI

Provincia Françeskane ka mbi supë një trashëgimni materiale dhe imateriale shumë të madhe dhe tepër të rëndësishme jo vetëm për vetë provincën, por edhe për mbarë Shqipërinë, rajonin dhe Europën.



Franceskanët e mëdhej shqiptarë kanë shënjuar hapja tepër të rëndësishëm në letërsi, gjuhësi, filozofi, memuaristikë, folklor, etnografi, antropologji, histori, arkeologji, muzeologji, arkivistikë, diplomatikë, arkitekturë, muzikë ...

Në faqen 12

# ZGJEDHJET VENDORE PARTITË

Kryetari i KQZ-së ka votuar kundër regjistrimit të "Bindjes": Nuk ka lindur juridikisht

## KQZ-ja regjistron "Bindjen Demokratike", në zgjedhje marrin pjesë 42 parti

Ballistët tradhtojnë PD-në, do të marrin pjesë në zgjedhje

Ndonëse pa opozitën kryesore në vend, fleta e votimit për zgjedhjet e ardhshme vendore që janë parashikuar të mbahen në 30 qershor do të përmbajë plot 42 parti politike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi dje me shumicë votash regjistrimin edhe të 8 partive të tjera politike, që kishin shfaqur interes për të qenë pjesë e garës zgjedhore për pushtetin vendor, duke e çuar kështu në 42 numrin total të partive të regjistruara për këto zgjedhje. Shumica e partive të regjistruara në këto zgjedhje janë aleatë të Partisë Socialiste, ndërkohe që një numër më i vogël, rreth 10 janë parti ose kanë qenë aleatë të PD-së, ose janë në opozitë me socialistët. Ndërmjet 8 partive të regjistruara gjatë ditës së djeshme, bie në sy edhe regjistrimi i forcës më të re politike në vend, "Bindjes Demokratike", me drejtues Astrit Patozin. Në fakt, regjistrimi i "Bindjes Demokratike" vjen me shkelje ligjore, kjo për vetë faktin se ajo bëri kërkesë për t'u regjistruar në zgjedhje, para se gjykata të kishte vendosur për regjistrimin e saj si parti politike. Në të njëjtën datë, "Bindja Demokratike" bëri kërkesë për regjistrim në gjykatë dhe po në të njëjtën ditë, vetëm pak minuta më pas paraqiti kërkesë zyrtare edhe për t'u regjistruar në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Kërkesë kjo, që u miratua dje nga KQZ-ja me 4 vota pro dhe votën kundër të kryetarit të këtij komisioni, Klemn Zguri. Gjatë diskutimit të këtij vendimi, kryetari i KQZ-së kundërshtoi duke theksuar se "Bindja Demokratike" nuk mund të regjistrohej, pasi nuk kishte plotësuar dokumentacionin ligjor që përcakton Kodi Zgjedhor. "Unë si zyrtar i shtetit dhe si administrator i zgjedhjeve, nuk mundet dhe nuk mund t'ia lejoj vetes që dëshirat e mia t'ia mbivendos ligjit. Edhe në momentin që flasim, vendimi i gjykatës nuk ka marrë



**ZGURI**  
"Unë si zyrtar i shtetit dhe si administrator i zgjedhjeve nuk mundet dhe nuk mund t'ia lejoj vetes që dëshirat e mia t'ia mbivendos ligjit. Edhe në momentin që flasim, vendimi i gjykatës nuk ka marrë formë të prerë, ç'ka nënkupton se partia 'Bindja Demokratike', akoma nuk ka lindur në kuptimin juridik dhe nuk mund të bëjë veprime", - tha Zguri. Më tej ai shtoi se ka pasur precedentë të mëparshëm kur KQZ në të njëjtat kushte ka votuar me votë unanime kundër regjistrimit.

### Rrjedhje të tjera në opozitë, 2 aleatë të PD-së bëhen deputetë

Vazhdojnë rrjedhjet në kampin e djathtë. Pas 30 kandidatëve të parë që kanë pranuar të marrin mandatin e deputetit, në KQZ vijojnë kërkesat e kandidatëve të tjerë që duan të futen në Kuvend si të zgjedhur të popullit. Kështu, KQZ-ja i ka dhënë dje mandatin e deputetit kandidatit Klajdi Qama, që vjen nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarku Berat, duke çuar kështu në 31 numrin e deputetëve në Kuvend. Por lista nuk do përfundojë me kaq, pasi dy aleat të tjerë të PD-së në zgjedhjet e shkuara kanë dorëzuar në KQZ formularin e dekriminalizimit, ç'ka shënon edhe momentin që i hap rrugë KQZ-së që



të vijojë procedurat për dhënien e mandatit të deputetit. Bëhet fjalë për aleatin e Partisë Demokratike, kryetarin e Partisë Demokratice, Kujtim Gjuzit, i cili ka kërkuar të marrë mandatin e deputetit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Koçi Tahiri në zgjedhjet e shkuara ka kandiduar në listat e Partisë Demokratike në qarkun e Korçës. Ish-aleati i

PD-së është me arsim të lartë dhe me profesion agronom dhe do të futet në Kuvend në moshë 70-vjeçare. Ndërkohë që krahas tij duket se më së fundi i ka ardhur radha për të marrë mandatin edhe kryetarit të Partisë Konservatore, Kujtim Gjuzit, po ashtu aleat i PD-së në zgjedhjet e shkuara. Kujtim Gjuzi në zgjedhjet e shkuara ishte pjesë e listës shumemërore të PD-së për qarkun Durrës. Kujtim Gjuzi deklaroi në formularin e dekriminalizimit se ka jetuar për një vit në Greqi, por jo për punë, por për turizëm. Por, ky detaj i deklaruar në formularin e Kujtim Gjuzit të dorëzuar së fundmi nuk ka qenë deklaruar në formularin e dekriminalizimit të dorëzuar në 2017-ën.

formë të prerë, ç'ka nënkupton se "Bindja Demokratike" nuk mund të regjistrohej, pasi nuk kishte plotësuar dokumentacionin ligjor që përcakton Kodi Zgjedhor. "Unë si zyrtar i shtetit dhe si administrator i zgjedhjeve, nuk mundet dhe nuk mund t'ia lejoj vetes që dëshirat e mia t'ia mbivendos ligjit. Edhe në momentin që flasim, vendimi i gjykatës nuk ka marrë

se gjysma e anëtarëve që jemi këtu kemi qenë prezentë, kemi qenë aktorë, kemi votuar 7 me 0 që një subjekt të mos regjistrohet dhe që ishte në të njëjtat kushte që të mos regjistrohej për zgjedhjet e vitit 2015. Zgjedhjet janë të qytetarëve, duhet të kenë alternativat të bollshme dhe të jenë të ndershme dhe të demokratike, por mbi të

gjitha duhet të jenë ligjore. Unë nuk jam i bindur se subjekt i në fjalë plotëson kriteret e ligjore për të garuar në zgjedhjet", - u shpreh Zguri. Pavarësisht kundërshtimit të tij, anëtarët e propozuar nga aleatët në KQZ votuan me shumicë votash që "Bindja Demokratike" të bëhet pjesë e këtyre zgjedhjeve. Ndërkohë që po gjatë ditës së



### LISTA, NGA KOMUNISTËT, BALLISTËT TË LIBRA, JA PARTITË E REGJISTRUARA

1. Partia Socialiste e Shqipërisë - **Edi Rama**
2. Partia Socialdemokrate Shqiptare - **Skënder Gjinushi**
3. Partia e Gjelbër - **Edlir Petanaj**
4. Partia Kristian Demokratike - **Dhimitër Muslia**
5. Partia Aleanca Demokratike - **Zef Bushati**
6. Partia Socialiste e Moderuar - **Gjergji Koja**
7. Partia Unitetit Kombëtar - **Idajet Beqiri**
8. Partia Emigracionit Shqiptar - **Kostaq Papa**
9. Partia e Personave me Afërsi të Kufizuara - **Gjovalin Shqalishi**
10. Partia Lëvizja Punëtorë Shqiptarë - **Genci Sakaj**
11. Partia e të Drejtave të Mihuara - **Ilir Vata**
12. Partia Demokratice e Re Europiane - **Koçi Tahiri**
13. Aleanca për Barazim dhe Drejtësi Europiane - **Valentino Mustaka**
14. Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet - **Kujtim Muça**
15. Partia Ardhmëria Shqiptare - **Emin Subashi**
16. Minoriteti Etnik Greq për të Ardhmen - **Kristo Kico**
17. Partia për Demokraci dhe Solidaritet - **Gaqo Apostoli**
18. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të emigrantëve - **Ymer Kurti**
19. Partia Komuniste e Shqipërisë - **Qemal Cicolari**
20. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar - **Ylber Valteri**
21. Partia Ora e Shqipërisë - **Zef Shqefni**
22. Partia Bashkimi Liberal Demokrat - **Arian Starova**
23. Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë - **Arian Galdini**
24. Partia Kombëtare Konservatore - **Kujtim Gjuzi**
25. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve - **Kadri Isufaj**
26. Fryma e Re Demokratike - **Bamir Topi**
27. Lista e Barabartë
28. Partia Zgjidhja - **Koço Kokëdhima**
29. Partia Demokratice Sociale - **Faskal Milo**
30. Partia Ligj dhe Drejtësi - **Spartak Ngjela**
31. Partia Socialpunëtorë Shqiptarë - **Ramodan Ndreka**
32. Partia e Reformave Demokratike - **Krenar Rryçi**
33. Pajtimi Kombëtar Shqiptar - **Spartak Dobi**
34. Aleanca Kuq e Zi - **Kreshnik Shkupi**
35. Bindja Demokratike - **Astrit Patozi**
36. Partia Aleanca e Maqedonasve - **Edmond Themelko**
37. Partia Balli Kombëtar - **Adriatik Alimadhi**
38. Partia G-99 - **Redi Shtino**
39. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare - **Eduart Abazi**
40. Partia Aleanca Arbore Kombëtare - **Gjet Ndoj**
41. Partia Shqipëria e Re - **Artion Koroha**
42. Partia Aleanca Popullore - **Ortur Dojaka**

djeshme, KQZ-ja votoi edhe regjistrimin e një tjetër aleati të PD-së si subjekt zgjedhor. Bëhet fjalë për Partinë Balli Demokrat të kryesuar nga Adriatik Alimadhi. Ndërkohë që më parë KQZ-ja ka regjistruar edhe disa subjekte të tjera, që më parë kanë qenë aleatë të PD-së. Bëhet fjalë për Partinë Ora e Shqipërisë me kryetar Zef Shqefni, Partinë Bashkimi

Liberal Demokrat me kryetar Arian Starova, Partinë për Liri, Demokraci dhe Etikë të Arian Galdinit apo edhe Partia Kombëtare Konservatore me kryetar Kujtim Gjuzi. Kujtojmë se Alimadhi, Shqefni dhe Gjuzi ishin pjesë e listave të kandidatëve të PD-së në zgjedhjet e shkuara parlamentare, ndërsa tashmë kanë pranuar mandatin e deputetit.



## SHKURT

## PD: 'Bindja' është opozitë fasadë, patericë e Edi Ramës

Partia Demokratike e akuzon partinë më të re të dalë nga gjiri i saj, Bindjen Demokratike të Astrit Patozit si një patericë e qeverisë. Demokratët kanë denoncuar dhe si anti-ligjore regjistrimin e Bindjes Demokratike nga KQZ, duke theksuar se ky veprim tregon edhe një herë se kjo forcë është patericë e Ramës, me qëllim që të zbehë mungesën e opozitës së vërtetë në zgjedhje. "Arsyeja pse Edi Rama vendosi që të uzurponte KQZ, duke emëruar në kundërshtim me ligjin 4 anëtarë nga PS, është që, sa herë ka zgjedhje, të shpikë rregullat e lojës sipas qejfit. Sot vendosi të regjistrojë Bindjen si opozitë fasadë, si patericë e tij në zgjedhje me synimin për të zbehur mungesën e opozitës së vërtetë. Vendimi i paligjshëm dhe politik i shumicës së Ramës në KQZ është një tjetër provë për opozitën të Edi Rama është armik i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme", - shkroi përfaqësuesi ligjor i PD-së në KQZ, Ivi Kaso. Sipas tij Bindja Demokratike nuk duhet të ishte regjistruar nga KQZ pasi nuk ka një vendim përfundimtar të regjistrimit në gjykatë. "Sot KQZ ka vendosur të regjistrojë si parti politike në zgjedhje, një subjekt që ligjërisht nuk konsiderohet parti politike, për shkak se vendimi i regjistrimit i shkallës së parë nuk ka marrë formë të prerë. KQZ, ka rrezuar edhe qëndrimin e vet të mëparshëm për këtë çështje, kur në një rast identik me votim 7 me 0 kishte vendosur mosregjistrimin e subjektit në zgjedhje. Rama e ka të kotë. Populli ka vendosur që në datën 30 qershor nuk ka për të pasur zgjedhje!", - shprehet Kaso në komentimin e vet.

## Patozi ironi me PD: Do i kërkojmë KQZ të shtyjë afatin e regjistrimit

Kreu i Bindjes Demokratike, Astrit Patozi ka reaguar pas akuzave të Partisë Demokratike për regjistrim të paligjshëm nga ana e KQZ-së. Duke e konsideruar regjistrimin në KQZ plotësisht të ligjshëm, Patozi me ironi deklaroi se do të kërkojë nga KQZ që të shtyjë afatin që të hyjë në zgjedhje edhe PD-ja. "Do t'i kërkojmë KQZ-së të shtyjë afatin që të hyjë në zgjedhje edhe PD-ja. Sot pamë se më të mërziturit që ne u regjistruam për të garuar në zgjedhjet e 30 qershorit nuk ishin konkurrentët e tjerë, por ata që kanë vendosur vetë të mos hyjnë. Kanë 10 ditë që në PD nuk merrmë me asnjë punë tjetër, përpos përpjekjeve për të akuzuar dhe mos lejuar Bindjen Demokratike që të marrë pjesë në zgjedhje. E kanë marrë me aq pikëllim sa janë gati që të bëjnë çfarë t'u thotë qeveria, vetëm që ne të mos regjistrohemi. Sa për ne, jemi të gatshëm që t'i drejtohem i KQZ-së që ta shtyjë afatin e regjistrimit të partive që t'u japin një mundësi tjetër këtyre të mërziturve se mbase ndërrojnë mendje dhe futen edhe ata në zgjedhje", - shkroi Patozi.

Kreu i qeverisë prezantoi Gledian Llatjan si kandidat për Bashkinë e Elbasanit

# Rama: Zgjedhjet në 30 qershor, fitojmë të gjitha bashkitë e vendit

"Ajaxi mund të dalë kampion Europe, por kampion këtu është PS"

Partia Socialiste është e bindur, jo vetëm në vendimin e saj për të shkuar në zgjedhjet vendore të 30 qershorit edhe pa praninë e opozitës, por edhe të fitojtë të 61 bashkitë. Nga Elbasani ku vijoi turin e tij "Bashkia që duam" për prezantimin e Gledian Llatjas si pasardhës të Qazim Sejdit, kryeministri Edi Rama edhe një herë ka konfirmuar vullnetin e mazhorancës që ai drejton për të shkuar në zgjedhje dhe për t'i fituar të gjitha bashkitë. "Të jeni të sigurt për një gjë, Ajaxi mund të dalë kampion Europe, por kampion këtu ka qenë, është dhe do të mbetet Partia Socialiste e Shqipërisë! Ajaxi mund ta marrë kupën e kampioneve dhe mund ta meritojë, se lozin shumë bukur, ndërsa bashkitë e Shqipërisë do t'i marrë dhe do t'i drejtojë Partia Socialiste e Shqipërisë në 30 qershor, nga Kukësi deri në Skrapar, nga Shkodra deri në Sarandë, nga Durrësi deri në Korçë. Thonë, pse të gjitha do i merrni ju? Po, të gjitha do i marrim. Të gjitha do t'i marrim, sepse kudo, ne mund të bëjmë, duhet të bëjmë dhe do të bëjmë më shumë për njerëzit, sidomos aty ku deri më sot kanë qeverisur ata", - tha kryeministri Edi Rama në fjalën e tij. Më tej ai falënderoi kryetarin aktual të Bashkisë së Elbasanit, Qazim Sejдинin për punën e bërë në këtë qytet, ndërsa theksoi se Llatja do vijojë punën e nisur prej tij për transformimin e gjithë bashkisë. "Më vjen shumë mirë që pasi kemi ardhur këtu për të kërkuar mandatin që tanimë Qazimi po e mbyll me nder dhe me një gjurmë që do të mbetet përgjithmonë në kujtesën e qytetit, ju kam thënë, na jepni besimin dhe ne do t'ua shpërblejmë, duke bërë për Elbasanin në 4 vjet, sa nuk është bërë në të gjitha vitet e tjera, të marra së bashku!", - u shpreh kryeministri. Në fjalën e tij Rama u mor gjatë edhe me vendimin e opozitës për të dalë nga parlamenti dhe për të mos marrë pjesë në zgjedhje. Ai theksoi se mazhoranca që ai drejton ka bërë gjithçka që opozita të mos dilte nga sistemi, por kjo theksoi ai nuk do i pengojë shqiptarët që të shkojnë në zgjedhje në 30 qershor. "Ne kemi bërë gjithçka kemi mundur që të mos vinte dita që zgjedhjet të bëheshin pa pjesën më të



## OPOZITA

"Janë katandisur që festonin fitoren e Ajaxit, sikur kishin mundur Partinë Socialiste! Një parti politike që feston fitoren e Ajaxit, ngaqë unë jam me Juventusin. Ajaxi fitoi me lojë të bukur, nuk fitoi duke gomat para stadiumit. Ajaxi fitoi me lojë të bukur, nuk fitoi duke thënë, ne nuk hujmë në fushë, po nuk hoqët skuadrën e ta zëvendësoni me një skuadër tjetër dhe po nuk e çuat Cristiano Ronaldo në shtëpi".

## Rama pritet me protesta në Elbasan, policia shoqëron 11 qytetarë

Edhe gjatë vizitës së tij në Elbasan kryeministri Edi Rama është pritur me protesta. Dhjetëra militantë dhe mbështetës të Partisë Demokratike, të drejtuar edhe nga ish-deputetë demokrat kanë bllokuar rrugën hyrëse për në Elbasan, në rrethrotullimin e Bradasheshit, duke penguar kështu hyrjen e kryeministrit. Për të liruar rrugën kanë ndërhyrë forcat e policisë së Elbasanit dhe ato speciale



që kishin ardhur në ndihmë të bluve të këtij qyteti. Kjo bëri që mes tyre të kish-

te dhe përplasje fizike, ndërkohë që në momentin që ka kaluar eskorta e kryeministrit Rama, në drejtim të saj është qëlluar edhe me gurë, në tentativë për ta ndaluar. Pas këtij momenti policia ka ndërhyrë dhe ka shoqëruar në komisarjat rreth 11 persona, të cilët sipas saj ishin protagonistë të bllokimit të rrugës dhe situatës së krijuar. Kështu, burime nga policia bënë me dije se 11 personat janë shoqëruar për prishje të rendit publik.

rëndësishme të opozitës, sepse Partia Demokratike, bashkë me partinë e filxhanit, sidoqoftë janë të dy pjesë të rëndësishme të opozitës. Ma thoni, çfarë të bëjmë ne? T'u themi përsëri, hajdeni merrni çfarë të doni. Pse, këtë muhabet do bëjmë, sa herë ka zgjedhje? Jo! Kam dëgjuar edhe nga njerëzit tanë, që akoma mendojnë se këtu do gjendet një zgjedhje dhe do shtyhen zgjedhjet e ku di unë se çfarë. Në 30 qershor, këtu në këtë shesh do bëhet një festë e madhe. I gjithë Elbasani do falënderojë Qazim Sejдинin dhe do t'i japë bekimin e votave dhe të fitores pasardhësit të tij, Gledit, duke uruar që të vazhdojë në atë rrugë dhe të bëjë edhe më shumë", - tha më tej Rama. Gjithsesi Rama

la të kuptohet se është i gatshëm që të ulët sërish me Bashën për të gjetur një zgjidhje, por theksoi se këtë të fundit nuk e lë kryetarja e LSI-së. "Unë mund të merrmë prapë, por atë nuk e lë fallxhorja, se tani janë bërë dy. Unë i them hajde, ajo i thotë jo, edhe pak, se filxhani thotë, E-ja po bie, L-ja po ngrihet, edhe pak se kam parë E-në përmbys, hë pije edhe një. E mbyti me kafe turke, e shkatërroi. Është

rritur konsumi i kafes turke në gjithë zonën e SHQUP-it. Pyetini ata, piq kafel, fut filxhan, ndiz furnat, edhe icik, shoh një pemë këtu, ai po bie dhe hipin nëpër pemë", - u shpreh Rama. Kreu i qeverisë akuzoi sërish LSI-në se është forca politike që ka blerë më shumë vota edhe në Elbasan. "Le ta çojë dorën njëri që nuk ka pasur frikë se do vijë fallxhorja t'i blejë votën", - nënvizoi Rama.

## NJUOTIM SHITJE ME ANKAND

Zyra Permbarimore Fier me përmbarus gjyqësor Arian CEPELE me adresë Lagja "29 Nentori" godina e Gjykatës Fier nga mbrapa, njofton se më datë 18.04.2019-02.05.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientin e saj, do të zhvillohet. Ankand 1-1-re për shiten e pasurisë së paligjshme, me numër pasurie Nr. 7/92, ZK. 2830, me sipërfaqe 1124 m2 me adresë Patos, Fier, në pronësi Z.Haxhi & Gjyle Rrapaj me vlerë fillestare në ankand 4 960 000 (katërmilioni e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) LEK.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 697262655.

Pjesë e premtimeve, arritja e mesatares prej 2 mijë medikamentesh të rimbursueshme

# Basha prezanton programin për shëndetësinë, anulojmë PPP korruptive

## Paga 1200 euro për mjekët dhe 700 euro për infermierët

Pagat prej 1200 euro për mjekët, rritje e numrit të barnave të rimbursueshme, anulimi i PPP-ve dhe investimet në infrastrukturë dhe në burimet njerëzore, janë disa nga pikat kryesore të asaj që demokratët premtojnë të bëjnë në fushën e shëndetësisë në momentin që do të vijjnë në pushtet. Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha i është rikthyer sërish dje programit të Partisë Demokratike në fushën e shëndetësisë, duke renditur edhe një herë prioritetet ku dhe do të fokusohet vëmendja e qeverisjes së djathtë. Përmes një statusi në Facebook, kryedemokrati Lulzim Basha ka shpalosur një pjesë të premtimeve që thekson se do t'i realizojë sapo të largojë qeverinë aktuale nga pushteti dhe t'i kthejë pushtetin qytetarëve. Dhe në krye të listës së këtyre premtimeve qëndron anulimi i marrëveshjeve të partneritetit publik privat në mjekësi. "Sistemi shëndetësor është në kolaps. Pasi t'u kthejmë pushtetin qytetarëve dhe ta heqim nga kthetrat e politikës të lidhur me krimin që mbajnë pushtetin me vota të blera, do të trajtojmë menjëherë dhe me prioritet problemet emergjente në shëndetësi. Me ligjin antimaia PD do të anulohet PPP korruptive në shëndetësi që i vjedhin buxhetit 33 milionë euro çdo vit. Çdo qindarkë e marrë në mënyrë korruptive do t'u kthehet qytetarëve", - shkroi Basha. Më tej ai rendit edhe disa nga premtimet e tjera po ashtu që prekin direkt buxhetin familjar të shqiptarëve dhe sidomos të moshave të treta. Kështu një nga premtimet e tjera të demokratëve është rritja e financimit të shërbimit shëndetësor, modernizim dhe decentralizim të tij. Sipas Bashës pacienti në qeverisjen e demokratëve do jetë i lirë të zgjedhë mes shërbimit në publik dhe atij privat, duke u njohur pagesa e sigurimeve. Gjithashtu, kryedemokrati i mëshon fort në këtë program për shëndetësinë ndërtimit të ambienteve të reja spitalore dhe qendrave shëndetësore, si dhe investimit në burimet njerëzore, i cili sipas tij "do të jetë prioriteti absolut". Natyrisht që në këtë drejtim ai ka bërë të ditur se do synohet që të ketë dhe paga dinjitoze për mjekët dhe infermierët, si një nga



mënyrat për të luftuar korrupsionin por edhe për të rritur cilësinë e shërbimit ndaj pacientit. "Paga minimale për mjekët do të arrijë në 1200 euro në muaj". Paga minimale për infermierët do të arrijë në 700 euro në muaj", - shprehet Basha në këtë status në Facebook. E saj i përket investimeve në burime njerëzore, kreu i demokratëve ka theksuar se një vëmendje e shtuar do t'i kushtohet edhe rritjes së numrit të studentëve që studiojnë për mjekësi. "Do të rrisim numrin e personelit duke nisur me një rritje të ndjeshme të numrit të studentëve që diplomohen në mjekësi. Rritje të financimit i për të rritur larmishmërinë e specializimeve dhe kualifikimeve dhe garantimin e kushteve të punës", - shkroi kryedemokrati. Gjithashtu pjesë e këtij programi do jetë edhe lufta kundër asaj që Basha e cilëson si mafia e ilaçeve. "Do të luftojmë mafien e ilaçeve, të instaluar nga Edi Rama sapo erdhni në pushtet. Qytetarët sot blejnë ilaçe të skuadua apo false që nuk kanë asnjë efekt në trajtimin e sëmundjeve. Ne do të rikthejmë barrierat mbrojtëse të standardeve evropiane për sigurinë e ilaçeve dhe do të rrisim listën e medikamenteve të rimbursueshme, duke synuar arritjen e mesatares evropiane prej 2 mijë medikamentesh nga 440 që është

### PREMTIMET E DEMOKRATËVE PËR SHËNDETËSINË

- Me ligjin antimaia PD do të anulohet PPP korruptive. Çdo qindarkë e marrë në mënyrë korruptive do t'u kthehet qytetarëve.
- Rritje të financimit të shërbimit shëndetësor, modernizim dhe decentralizim të tij.
- Pacienti do jetë i lirë të zgjedhë duke u njohur pagesa e sigurimeve.
- Ndërtimin e ambienteve të reja spitalore dhe qendrave shëndetësore.
- Investimi në burimet njerëzore do të jetë prioriteti absolut.
- Paga minimale për mjekët do të arrijë në 1200 euro në muaj.
- Paga minimale për infermierët do të arrijë në 700 euro në muaj.
- Do të rrisim numrin e personelit.
- Rritje të ndjeshme të numrit të studentëve që diplomohen në Mjekësi.
- Rritje të financimit për të rritur larmishmërinë e specializimeve.
- Luftim i mafisë së ilaçeve
- Rikthimi i barrierave mbrojtëse të standardeve evropiane për sigurinë e ilaçeve
- Do të rrisim listën e medikamenteve të rimbursueshme, duke synuar arritjen e mesatares evropiane prej 2 mijë.
- Do të rrisim vlerën e rimbursimit që sot është në masën 50-60% të vlerës.

sot dhe duke rritur vlerën e rimbursimit që sot është në masën 50-60% të vlerës", - deklaroi Basha në koment të vet. Sipas tij ku ka vullnet politik, ka edhe mundësi, ndaj me luftën kundër korrupsionit do mundësohen dhe arritja e shumë prej këtyre premtimeve. "Paratë që shkojnë për korrupsionin, për PPP-të apo zhdukjen pa lënë gjurmë, plot 1.7 miliardë euro vetëm vitin e kaluar sipas KLSH, do të orientohen drejt sektorëve prioritarë, ku në mënyrë absolute shëndetësia është tek më prioritarët", - shprehet Basha.

## Meta: Me besim te Zoti dhe dialog do ia dalim përballë arrogancës

Presidenti Ilir Meta ka uruar dje të gjithë besimtarët ortodoks me rastin e festës së Pashkës, ndërsa nuk ka harruar që të shfrytëzojë rastin për të përcjellë edhe disa mesazhe politike për dialog dhe bashkëpunim. Përmes një postimi në rrjetet sociale Meta shkruan se kjo festë duhet t'i shërbejë gjithkujt për të kuptuar se përpara të keqes, padrejtësisë, veseve, frikës dhe zhgënjimit, shpresa dhe e mira nuk vdesin kurrë. "Në vigjilje të krenarit të Ditës së Ringjalljes së Krishtit, u uroj nga zemra besimtarëve ortodoksë dhe mbarë popullit shqiptar: Nga mot gëzuar Pashkët! Mbarësi, shëndet, paqe e begati në familjet tuaja! Festa e Pashkëve dhe e dritës që nuk perëndon kurrë, na kujton sot se para malit të së keqes, padrejtësisë, veseve, frikës e zhgënjimit, mosbesimit e arrogancës, korrupsionit, dhunës dhe çdo fenomei negativ që vret paqen, drejtësinë e barazisë sociale dhe helmton rëndë shoqërinë, shpresa dhe e mira nuk vdesin kurrë", - shkroi Meta në urimin e vet. Më tej ai thekson se duke përqafuar vlerat morale dhe hyjnore shoqëria shqiptare mund të tejkalojë çdo sfidë. Ndaj ai bëri apel për të shumë harmoni dhe dialog. "Me besimin në Zot dhe duke përqafuar gjithmonë vlerat më të mira hyjnore, morale e sociale, por edhe kombëtare, me dashuri, harmoni të plotë, dialog, mirëkuptim, bashkëpunim e vëllazërim, secili prej nesh dhe shoqëria jonë në tërësi, mund të tejkalojë çdo sfidë, pavarësisht sakrificave, për të ecur e sigurt drejt së ardhmes më të mirë, në familjen evropiane", - thekson më tej Meta në këtë mesazh urimor. Gjithashtu, ai shprehet se ditë të tilla duhet ta bëjnë njeriun që të jetë më solidar dhe të tregojë më shumë përkujdesje ndaj atyre që janë në nevojë.



## Me helikopter në takime, Vasili: KLSH të kontrollojë shpenzimet e Ramës

Ish-kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integritim, Petrit Vasili ka denoncuar dje shpenzimet që po shoqërojnë turin e kryeministrit Edi Rama nëpër Shqipëri. Dhe kjo jo vetëm sa i përket shpenzimeve të organizimit të takimeve, por edhe eskortave që e shoqërojnë atë. Nëpërmjet një deklarate për mediat Vasili u shpreh se pamjet që shoqërojnë Ramën në çdo takim tregojnë an-

gazhimin e gjithë shtetit. "Qindra milionë lekë të qytetarëve paguajnë karvanin që kryeministri i marrë të mund frikërat e tij, që t'i japë kurajë vetes së tij për në pushtet që ka marrë fund. Ky kryeministër siç e keni parë dhe dje në Shkodër, por jo vetëm në Shkodër, por dhe në Kukës dhe mjaft rrethe të Shqipërisë, i trembur dhe i tmerruar unë nëpër qytetet shqiptare nga ajri me helikopter, sepse frikakët të tillë janë. Një kryemi-

nistër i popullit duhet të shoqërohet nga populli kur hyn nëpër qytete dhe jo nga karvani i policisë, i armatosur me kallashnikovë. Një vajtje e Edi Ramës me helikopter kushton 1 milion e 500 mijë lekë. I bëj thirrje këtu Kontrollit të Lartë të Shtetit të monitorojë dhe kontrollojë batërdimë e financimeve dhe shpenzimeve pa fund, që shoqërojnë karvanët e pushtetit i lart e poshtë nëpër Shqipëri", - tha Vasili.

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**  
 Rr. "Fah Daa", Kompleksi Kk2, Kufë 5, K. 1, Tiranë  
 Web: www.3h.al Email: shg@3h.al yano.com/0602029271

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.23.04.2019 deri ne dt. 02.05.2019 persendin e luajtshem- gjysem rirmorko, marka Shmitz, Spr me Targa AER 936, me crrim fillstar 199,824.00 Leke autometjtin gjysem rirmorko marka general trailers, F34 me Targa AER 360 me crrim fillstar 169,850.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L  
**Ankandit zhvillohet ne zyrën përmbarimore ne daten 02.05.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00**

**NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND**

1. Përmbarusi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje ne ankand pasurinë me te dhenat : "Ndertese njeqateshe industriale" me nr pasurie 1077ND / Volumi 24 , Faqe 143, me sipërfaqe ndërtimore 1 235 m<sup>2</sup> , Zona kadastrale 8592, e ndodhur tek zona industriale e qytetit , pjesë e ish parkut te mallrave , Shkodër .....e regjistruar ne favor te Altin Salini etj .  
 2. Cmiri me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpershkruar , është në vlerën : **24,240,000 ( njezete kater milione e dyqind e katerqindete mije ) leke .**  
 3. Shitja e pasurisë do te behet ( zhvillohet ) me date **03.05.2019 ora 16.16** ne Zyrën e përmbarusit gjyqësorë Gentil Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Partisalle Gjyqates se rrethit Gjyqësor Shkodër. Personat e interesuar duhet te derdhen përpara fillimit te ankandit 10 % te vlerës si garanci ne Tirana Bank dega Shkodër ne nr llogarie 0600-313839-100 CB .

**NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND**

Përmbarusi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje ne ankand pasurinë me te dhenat : "me te dhenat : "Trulli-Ndertese" me sip. totale 202.5 m<sup>2</sup> dhe nga kjo ndertese me sip.65 m<sup>2</sup> , me Nr pasurie 7934, vol 38, fq 125, Zk 8592 e ndodhur ne Lajçen Partizani , Shkodër.....e afishuar ne favor te debitorit Zmirr Hebovija .  
 2. Cmiri me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpershkruar , është në vlerën : **5,120,000 ( nentemijente e njeqind e njezet mije ) leke .**  
 3. Shitja e pasurisë do te behet ( zhvillohet ) me date **05.05.2019 ora 16.16** ne Zyrën e përmbarusit gjyqësorë Gentil Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Partisalle Gjyqates se rrethit Gjyqësor Shkodër. Personat e interesuar duhet te derdhen përpara fillimit te ankandit 10 % te vlerës si garanci ne Tirana Bank dega Shkodër ne nr llogarie 0600-313839-100 CB .


Hetuesit: Përgjimet e bisedave telefonike e ambientale na çuan tek autorët

## SHKODËR

Një ditë pas arrestimit të të rinjve Arsen Stojku dhe Mislim Rama nga fshati Mjedë i Bashkisë Vau i Dejës, të dyshuar si bashkëpunëtorë në vrasjen e dyfishtë të vëllezërve Astrit dhe Brahim Bilali janë zbardhur detaje të reja. Stojku dhe Rama, miq me njëri-tjetrin akuzohen për "Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve", ndërsa është shpallur në kërkim edhe shtetasi Ibrahim Lici, i dyshuar si autor kryesor në vrasje dhe shtetasi D.B., i dyshuar për "Përkrahje të autorit". Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se 25-vjeçari Stojku dhe 23-vjeçari Rama, të cilët akuzohen për atentatin e ndodhur më 30 mars në lagjen "Kiras" janë marrë në pyetje nga oficerët e policisë, por kanë mohuar të kenë lidhje me ekzekutimin mafioz të dy vëllezërve Bilali. Ndonëse seanca e pyetjeve për detajet e vrasjes së dyfishtë ka vijuar prej disa orësh, dy të arrestuarit nuk i kanë pranuar akuzat. Ndërkohë, grupi hetimor pretendon se ka prova të mjaftueshme që implikojnë dy të prangosurit. Sipas hetuesve, përgjimet e bisedave telefonike dhe ato ambientale çuan tek Arsen Stojku dhe Mislim Rama. Prokuroria e Shkodrës ka dyshime se dy të rinjtë në fjalë kanë lyer me bojë makinën, e cila është përdorur në vrasjen e Ibrahim dhe Astrit Bilalit. Pas vrasjes së dy vëllezërve në lagjen "Kiras", pak metra më tutje policia gjeti një makinë që po digjej. Zjarrfikëset bënë të mundur shuarjen e flakëve dhe makina nuk u dogj në brendësi. Sipas prokurorisë, pas akteve të ekspertizës, në mjet u gjetën gjurmë të dy shtetasve, Arsen Stojku dhe Mislim Rama. Por, ata janë justifikuar me faktin se kanë lyer mjetin, duke qenë se këtë punë bëjnë. Burimet e mësipërme pohuan se dy të arrestuarit janë të afërm të personit në kërkim, Ibrahim Lici, i cili konsiderohet nga prokuroria dhe policia si autori kryesor i atentatit të ndodhur afro një muaj më parë. Për Ibrahim Licin, në mjetin e sekuestruar nga policia nuk ka gjurmë të tij, por ai dyshohet si autor i vrasjes, kjo edhe nga përgjimet telefonike dhe ambientale, që janë bërë në lidhje me ngjarjen e rëndë. Nga kamerat e sigurisë së objekteve të ndryshme në Shkodër rezultoi se Rama, Stojku dhe Lici janë

# Ekzekutimi i vëllezërve Bilali, bashkëpunëtorët u zbuluan nga gjurmët e gishtave në makinën e krimi

## Arsen Stojku dhe Mislim Rama mohojnë akuzat gjatë marrjes në pyetje: Mjetin e lyer, se atë punë bëjmë



Të arrestuarit Arsen Stojku dhe Mislim Rama



Vëllezërit e vrarë Astrit dhe Brahim Bilali

## PËRGJIMET

Sipas hetuesve, përgjimet e bisedave telefonike dhe ato ambientale çuan tek Arsen Stojku dhe Mislim Rama. Prokuroria e Shkodrës ka dyshime se dy të rinjtë në fjalë kanë lyer me bojë makinën, e cila është përdorur në vrasjen e Ibrahim dhe Astrit Bilalit. Pas vrasjes së dy vëllezërve në lagjen "Kiras", pak metra më tutje policia gjeti një makinë që po digjej.

ndodhur në shoqëri me njëri-tjetrin herë pas here, para se të kryejë krimi. Motiv i vrasjes dyshohet se është hakmarrja, e cila lidhet me një zinxhir ekzekutimesh të ndodhura në qytetin verior dy vitet e fundit. Astrit dhe Brahim Bilali u vranë në afërsi të banesës së tyre. Astrit Bilali është baba i Asmer Bilalit, ish-kampioni i boksit, i arrestuar si pjesë e grupit Bajri.

**SHKODËR** - 26-vjeçari Ibrahim Lici është shpallur në kërkim nga policia si ekzekutori i vëllezërve Bilali. Por, ky ishte akti i fundit i sagës së hakmarrjeve dhe përplasjeve mes grupeve kriminale në Shkodër. Burime për "GSH" pohuan se ai është nipi i Fatbardh Licit, i vrarë më 8 gusht 2018 dhe djali i Mustafë Licit, anëtar i Këshillit Bashkiak në Sh-

## KUSH ËSHTË IBRAHIM LICË

kodër dhe drejtues i partisë Mendimi i Djathtë Liberal. Nga ana tjetër, viktima Fatbardh Lici është kunati i Lulzim Kullës, biznesmenit të njohur, ndaj të cilit u bë atentat më 13 janar të vitit të kaluar me lëndë shpërthyes, ku mbeti i plagosur. Ky atentat dyshohet se ishte dhe ngjarja që prishi qetësinë mes grupeve në Shkodër. Në këtë atentat të kryer pranë tregut me pop-

ullor të qytetit mbetën të plagosur 8 persona, mes të cilëve edhe vetë Kulla. Ngjarjet sipas policisë lidhen me hakmarrjen dhe përplasjen mes grupeve kriminale, si dhe aktivitetin e djalit të Astrit Bilalit që mbeti i vrarë më 30 mars, Asmiri, një ish-kampion i sportit të boksit, i arrestuar në shtator të vitit të kaluar si pjesë e grupit kriminal "Bajri". Grupet

kriminale që vepronë në Shkodër kanë një histori më shumë se 25-vjeçare, mbushur me vrasje, kërcënime, trafik droge, prostitucion, rrëmbim të pronave etj. Gjatë viteve, disa prej grupeve u larguan nga skena pas vrasjes së drejtuesve të tyre. Mbijetuan grupet më të fuqishme, ato që ishin organizuar në bazë familjeje.

## Gjenden armë dhe municione, në kërkim pronari i banesës

## Makina në ecje qëllon me armë në Velipojë, FNSH rrethon zonën

**SHKODËR** - Një arsenal armësh është sekuestruar dje nga policia pas të shtënave me armë në fshatin Lurëz, të njësisë administrative Velipojë. Sipas bluve, arsenalin i armëve është gjetur në banesën në pronësi të shtetasit G.S., e pabanuar, ndërsa është shpallur në kërkim ky i fundit. Granat-hedhës (blind shpues), silenciator, radio policie, rreth 700 fishekë luftarakë, krehra me fishekë kallashnikov, dy telefona dhe një targë motoçiklete, mësohet të jetë një pjesë e arsenalit të sekuestruar sot nga policia. "Në vijim të krehjes së zonës për gjetjen dhe arrestimin e personave që qëlluan me armë zjarr në ajër, në afërsi të fshatit Luarëz të Njësisë Administrative Velipojë, ku shërbimet

e policisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër të mbështetura nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe të FNSH Shkodër rrethuan zonën në një perimetër të gjerë, grupi hetimor mori informacion se autorët e mundshëm kanë lëvizur në drejtim të fshatit Luarëz dhe se mund të jenë fshetur në banesat e këtij fshati. Në bazë të këtij informacioni, strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, të Komisarariatit të Policisë Shkodër të mbështetura dhe nga FNSH Shkodër kanë organizuar dhe zhvilluar operacionin policor të koduar "Luarëz", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq,



mësohet se gjatë operacionit, policia ka ushtruar kontroll në disa banesa, ku është marrë informacion për një arsenal armësh, që mund të ishin të fshehura në banesë në pronësi të shtetasit G.S., në të cilën nuk banonte njëri. FNSH-ja dhe Policia e Shkodrës pas marrjes së masave për rrezikshmërinë

që mund të kishte ky kontroll, pasi dyshohej se aty mund të ishin fshehur autorët, ka ushtruar kontroll në banesën e shtetasit G.S., ku ka gjetur dhe sekuestruar arsenalin luftarak. Pas veprimeve të para procedurale, u bë shpallja në kërkim e shtetasit G.S. 50 vjeç, për veprën penale të "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve" parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal. "Grupi Hetimor ka fiksuar prova të vlefshme në këtë banesë, që do t'i shërbejnë hetimit edhe për ngjarjet të ndodhura më parë. Vijon operacioni dhe krehja e zonës për kapjen e autorëve", bëri me dije policia.

**EPSA** SHOERIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A." SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :

"Ullishte (Truall)" me sip. 14.700 m<sup>2</sup>, Nr. Pasurie 56/3, Vol.29, Fq.15, ZK 8605, i ndodhur ne Vlorë 5, Vlore dhe "Objekt karabina 4 Kat + 1 Kat bodrum" me sip. 1.262 m<sup>2</sup>, Nr. Pasurie 56/3-ND, ZK 8605, i ndodhur ne L.11 Janari, Vlore ne pronesi te Shkolla Internacional shpk. Keto pasuri jane hipotekuar ne favor te Banka ProCredit sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 3.135.524 Euro. Ankandi zhvillohet date 09.05.2019 ora 16.00 ne adresen Rr."I. Qemali", Palli "Fratrian", K.6, Tirane  
Per cdo informacion mund te kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne web www.epsa.al.

50-vjeçari pejan u zbulua pas dëshmisë së të penduarit Alkond Bengasi

# Megagrabitja në Rinas, Ragip Hajdini nga Kosova, njëri prej organizatorëve

## Policia zbarkon në shtëpinë e "Dajës", ja ku u "ngjiz" plani i bastisjes në aeroport

TIRANË

Ragip Hajdini nga Kosova dyshohet të jetë një prej organizatorëve të grabitjes spektakolare brenda pistës së Rinasit mesditën e 9 prillit. Në këtë përfundim ka dalë grupi hetimor pas analizimit të të gjitha provave të grumbulluara deri në momentin e arrestimit të tij. Në kërkim të Hajdinit, policia u vu pas dëshmisë së bashkëpunëtorit të drejtësisë, Alkond Bengasi, i cili u tha hetuesve se pjesë e grupit kriminal ishte edhe një shtetas nga Kosova, rreth 50 vjeç, dhe qëndronte në shoqërinë e Admir Muratajt. Grupi i hetimit duket se nuk e pati të vështirë identifikimin e 50-vjeçarit, për sa kohë Hajdini ishte i skeduar më herët nga policia e Kosovës, por edhe sepse bashkëpunëtori i drejtësisë arriti mes disa fotosh të vinte gishtin te shtetasi kosovar. Dyshimet janë se ai bashkë me mikun e tij Murataj dhe Klement Çalën nisën ta thurnin planin e grabitjes 6 muaj më parë, në një restorant në zonën e "Shkëmbit të Kavajës", ku edhe jetonte shtetasi kosovar. Hetuesit thanë se apartamenti ku Hajdini u arrestua ishte në pronësi të tij, çka nënkupton faktin se ai përfundimisht pjesën më të madhe të kohës jetonte në Shqipëri dhe rrinte në shoqërinë e Admir Muratajt, i cili mbeti i vrarë me plumb në kokë pas grabitjes gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë. Hetuesit zbarkuan në hyrjen e 50-vjeçarit, ku kanë



### IDENTIFIKIMI I "DAJËS"

Grupi i hetimit duket se nuk e pati të vështirë identifikimin e 50-vjeçarit, për sa kohë Hajdini ishte i skeduar më herët nga policia e Kosovës, por edhe sepse bashkëpunëtori i drejtësisë arriti mes disa fotosh të vinte gishtin te shtetasi kosovar. Dyshimet janë se ai bashkë me mikun e tij Murataj dhe Klement Çalën nisën ta thurnin planin e grabitjes 6 muaj më parë në një restorant te "Shkëmbi i Kavajës".

ushtruar një kontroll të imtësishtëm, por nuk jepën detaje nëse janë gjetur prova komprometuese kundër shtetasit kosovar, që thirrrej me nofkën "Daja". Ragip Hajdini, referuar dëshmisë së Bengasit, rezultoi se gjashtë ditë para grabitjes së Rinasit është parë në zonën e Liqenit të Thatat, në shoqërinë e Muratajt, duke udhëtuar me një automjet "Golf" ngjyrë të bardhë me targa të Kosovës. Kjo dëshmon sipas hetuesve miqësinë e ngushtë që kishin Murataj dhe Hajdini, të cilët

e thërrisnin njëri-tjetrin me nofkën "Daja" dhe faktin se ata kanë hartuar së bashku planin e grabitjes dhe kanë siguruar infrastrukturën e nevojshme, për sa kohë që Bengasi tregon se furgoni me të cilin grupi i armatosur u fut në pistë, sipas tij ishte sjellë nga Kosova. Megjithatë, dëshmia e bashkëpunëtorit të drejtësisë nuk hedh dritë mbi faktin nëse "Daja" nga Kosova është në mesin e pesë grabitësve që shkatërruan rrethimin e Rinasit dhe morën nga barku i një avioni milio-

### GRABITJA E ARIT

"Daja", i arrestuar si i gjashti i dyshuar për grabitjen në Rinas, akuzohet për veprimtari kriminale edhe në Kosovë. Ragip Hajdini rezultoi me precedent të ngjashëm penalë edhe në Kosovë, aty ku ka qenë i dyshuar për grabitjen e 25 kg ar nga Dhoma e Dëshmive në Policinë e Pejës, siç raporton media kosovare Insajder. Ngjarja ka ndodhur në prill të vitit 2012.

na euro. Gjurmët e gishtërinjve të gjetura në furgonin me mbishkrimin "Hetimi taimor" janë mundësia më e mirë për hetuesit, për të provuar se cilët ishin grabitësit që përshkruan pistën e avionëve. Veç Admir Muratajt që mbeti i vrarë, dyshimet janë se në pistë kanë hyrë edhe Oltion Veseli e Klement Çala. Ky i fundit bashkë me të vëllain, Eldi dhe Talo Çelën nga Elbasani vazhdojnë të jenë në arrati. Ndërkohë, Alkond Bengasi, kushëri me vëllezërit Çala,

Saimir Çela dhe Renaldo Sula nga Elbasani dhe Elton Pikli nga Fushë-Kruja dyshohen si bashkëpunëtorët kryesorë të grupit të dhunshëm. I vetmi që ka pranuar se ka dijeni për ngjarjen duke përfutur statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë është Alkond Bengasi, kushëri me Klement Çalën. Të tjerët deri më tani kanë mohuar çdo përfshirje në grabitjen spektakolare dhe i janë drejtuar Gjykatës së Apelit, ku kanë kërkuar lirinë.

### GJURMËT

Megjithatë, dëshmia e bashkëpunëtorit të drejtësisë nuk hedh dritë mbi faktin nëse "Daja" nga Kosova është në mesin e pesë grabitësve që shkatërruan rrethimin e Rinasit dhe morën nga barku i një avioni miliona euro. Gjurmët e gishtërinjve të gjetura në furgonin me mbishkrimin "Hetimi taimor" janë mundësia më e mirë për hetuesit, për të provuar se cilët ishin grabitësit që përshkruan pistën e avionëve.

### SHKURT

#### 400 fidanë kanabis gati për kultivim, 1 në pranga

VLORE – Gjatë kontrollit të territorit për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e kultivimit të bimëve narkotike, shërbimet e policisë në fshatin Treblovë të Selencicës kanë konstatuar pranë një përroi rreth 400 fidanë të dyshuara si kanabis, gati për t'u kultivuar. Në përfundim të veprimeve të para hetimore, policia ka arrestuar në flagrancë shtetasin K.V., 57 vjeç, i dyshuar për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike". Po ashtu, u procedua në gjendje të lirë kryeplaku i fshatit, shtetasi B.M., 61 vjeç, për veprën penale "Shpërdorim detyrë", pasi dyshohet se nuk ka përmblushur detyrat për kontrollin e territorit.

#### Misteri, i dënuari mbërrin i vdekur në spital

FIER – Një 40-vjeçar nga burgu i Fierit ka mbërritur i vdekur paradien e djeshme në spitalin e këtij qyteti. Bëhet fjalë për të dënuarin Dritan Zeqiri, 40 vjeç, nga Përmeti. Mësohet se ai ka mbërritur në spital pa shenja jete dhe është dërguar në morgun e qytetit për ekspertizë mjekoligjore. Janë të paqarta shkaqet që mund t'i kenë shkaktoar vdekjen, ndërkohë që hetimet për rastin kanë nisur tashmë. Paraprakisht dyshohet për çarje të aortës abdominale.

#### Dhunon vajzën e ish-gruan, kapet vlonjati

VLORE – Policia e Vlorës ka arrestuar në flagrancë për dhunë në familje dhe plagosje të lehtë me dashje 45-vjeçarin G.K., me banim në Vlorë. Mësohet se mbremjen e së premtes, në lagjen "10 Korriku" të qytetit bregdetar, ky shtetas për motive të dobëta ka ushtruar dhunë fizike ndaj ish-bashkëshortes dhe vajzës së tij si dhe ka goditur edhe një shtetas tjetër, i cili po kalonte rastësisht dhe ka ndërhyrë për të qetësuar situatën. Materialet në ngarkim të 45-vjeçarit iu referuan prokurorisë për veprat penale "Dhuna në familje" dhe "Plagosje e lehtë me dashje".

### Procedohet edhe pronari i lokalit

## Iu gjenden kokainë e armë, pranga 2 shpërndarësve

BERAT – Policia e qarkut të Beratit ka finalizuar me sukses operacionin e koduar "Osumi" në Çorovodë. Në pranga kanë përfunduar dy persona, ndërsa është shpallur në kërkim një tjetër për shpërndarje të lëndëve narkotike dhe armëmbajtje pa leje. Mësohet se pas një hetimi dymujor, mbremjen e së premtes është bërë e mundur që në një lokal të kapën dhe arrestuan në flagrancë shtetasit: P.K., 46 vjeç, banues

në Çorovodë, të cilit gjatë kontrollit fizik iu gjetën dhe sekuestruan, 11 doza kokainë, 520 euro, 57.400 lekë dhe 4 aparate celular. Gjithashtu, është arrestuar 37-vjeçari E.H., (i dënuar më parë), 37 vjeç, të cilit gjatë kontrollit fizik iu gjetën dhe sekuestruan 1 pistoletë me 6 fishekë dhe 1 dozë kokainë, si dhe gjatë kontrollit në banesë iu gjetën një sasi farash kanabis sativa, 1 armë gjahu dhe 27 gr kanabis. Ndërkaq, ka filluar procedimi



penal në gjendje të lirë për shtetasin L.S., 44 vjeç, (pronar i lokalit) për veprën penale "Moskallëzim krimi". Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", "Mbajtja e armëve dhe municioneve pa leje", "Mbajtja e armëve të gjahut pa leje".

## Festa e Pashkëve, 7 mijë emigrantë kthehen nga Greqia

KAPSHITICË – Është rritur në doganën e Kapshiticës, fluksi i emigrantëve që kthehen në atdhe për Pashkë. Mësohet se vetëm gjatë 24 orëve të fundit kanë hyrë nga Greqia rreth 7338 persona. Ndërkohë, i lartë raportohet të jetë edhe numri i qytetarëve që kanë udhëtuar drejt Greqisë. Sipas burimeve të policisë kufitare, të paktën 4782 qytetarë kanë dalë nga territori ynë në 24 orët e fundit. Situata në doganë është e qetë dhe nuk raportohen radhë apo edhe vonesa. Punohet me 7 sportele për të përballuar fluksin, të cilët alternohen në varësi të ngarkesës së punës.



Ministrat në Morinë: Të angazhuar për përbalimin e fluksit gjatë sezonit veror

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ka bërë të ditur dje se do të skanohet kontrata koncesionare me kompaninë kineze në aeroportin e Rinasit. Në një prononcim për mediat, ministria Belinda Balluku i është përgjigjur interesit të mediave në lidhje me autorizimin e Avokatit të Shtetit për të kontraktuar një studio ndërkombëtare ligjore, për shërbim konsulence, sa i takon marrëveshjes koncesionare me kompaninë kineze në aeroportin e Rinasit. "Përsa i përket një kontrate konsulence që Avokati i Shtetit ka aplikuar për zgjidhjen e problematikës që ne kemi me kontratën koncesionare, kemi të gjithë të drejtën si shtet të aplikojmë për ta pasur mbështetje ligjore nga studio të njohura ndërkombëtare dhe kjo nuk përket heqas as në zgjidhje të kontratës koncesionare dhe as në vazhdim. Ne kemi kërkuar një mbështetje ligjore për ta sonduar dhe skanuar atë kontratë, e cila është problematike për të gjithë partnerët që operojnë në aeroport, edhe për Policinë e Shtetit, edhe për shtetin shqiptar, nganjëherë edhe për cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve atje. Kështu që nuk ka asgjë të fshehur prapa kërkesës së Avokatit të Shtetit për mbështetjen nga

# Konsulencë për Rinasin, Balluku: Do të skanojmë kontratën me kinezët

Avokati i Shtetit do të kontraktojë një studio ndërkombëtare ligjore



një studioje ligjore ndërkombëtare përsa i përket kontratës së koncesionit, thjesht ne po marrim masat maksimale për t'u ofruar të gjithë udhëtarëve shqiptarë siguri,

por edhe atyre të huaj të cilët janë mbi 6 milionë turistë në vitin e shkuar dhe presim edhe një rritje, kështu që ata meritojnë të gjithë fokusin e qeverisë shqiptare", tha Bal-

luku.

## TAKIMI

Në prag të sezonit turistik, ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku dhe ministri i

Brendshëm, Sandër Lleshaj inspektuan pikën kufitare të Morinës, ku kontrolluan nga afër masat e marra në këtë pikë, e cila ka fluksin më të lartë të lëvizjes gjatë sezonit veror. Balluku tha se të gjitha strukturat shtetërore janë të angazhuara për të ofruar një shërbim me cilësi sa më të lartë. "Pika kufitare e Morinës është një pikë shumë e rëndësishme, duke qenë se është pika që përpunon numrin më të madh të vizitorëve gjatë vitit dhe të gjitha strukturat shtetërore kanë një fokus dhe janë të përgjendruara për të ofruar shërbime sa më të mira. Shërbimet e integruara janë ato, të cilat ne synojmë, pasi zvogëlojnë kohën e pritjes dhe ofrohen në mënyrën më cilësore dhe me standarde më të larta", - u shpreh Balluku. Ndërsa, ministri i

Brendshëm, Sandër Lleshaj kërkoj nga autoritetet që të shtohen masat në drejtim të pritjes dhe menaxhimit sa më të mirë të fluksit të turistëve. "Do të marrim masa në bashkëpunim edhe me autoritetet e Kosovës që ta kompensojmë me masa të shtuara sigurie këtë liri të lëvizjes, që po rritet përditë e më shumë. Duke qenë se jemi edhe në prag të sezonit turistik, unë gjej rastin të kërkoj nga autoritetet dhe t'i inkurajoj ato për të shtuar masat në drejtim të pritjes dhe menaxhimit sa më të mirë të fluksit të turistëve, me qëllim që ai të rrjedhë i lirshëm, por edhe i sigurt. Të shtohen ato masa që tradicionalisht janë ndërmarrë për patrullimin e përbashkët, për kontrollin e përbashkët e çështje të tjera", - tha Lleshaj.



## NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03.05.2019, ora 11:00.
- Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
- Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Afati i evadimit:** 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e naftës brut, sasia 75 101 ton.
- Vlera fillestare:**

### Ne kushtet FOB:

Çmimi minimal fillestar per njësi është:

**75.27 % e Çmimit Brent + K**

### Në pikat e lëvrimit:

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

**75.27 % e Çmimit Brent – 2.97 USD/bbl + K**

- 75.27 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (pesha specifike, aciditeti i naftës, % e squfurit).
- Brent është çmimi në \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik.
- 2.97 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).

- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlloritur nga formula (Ke"0).

- Vendndodhja e naftës brut: Albpetrol sha Patos:** Ne pikat e levrimt Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrez, Stacioni Kuçove, Stacioni Amonice.
- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 03.05.2019, ora 11:00.
- Data e hapjes së ofertave:** datë 03.05.2019, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

### 12. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha [www.albpetrol.al](http://www.albpetrol.al) dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë [www.infrastruktura.gov.al](http://www.infrastruktura.gov.al).

Dokumente me pagesë:

Po  Jo  X


- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.

## "EPIRI I VERIUT" DOSSIER

Zyrtarizimi i platformës shovene helene "Megali Idea"

# Si u krijua më 1914 qeveria e përkohshme vorioepirote

*Zografi kërkoi që edhe Lunxhëria të shpallej zonë pakice greke*



Dr. Hasan Luçi

(vijon nga numri i djeshëm)

**E**njëta gjë mund të thuhet edhe për Patriarkanën e Stambollit, frymëzuesja kryesore fetare e lëvizjes vorioepirote së bashku me kishën greke. Jo vetëm kaq por Patriarkana e Stambollit si dhe kisha greke janë qendra spjuanzive e agresioni propagandistik e diversiv, jo vetëm për të mbajtur gjallë ndjenjat shovene antishqiptare në radhët e ortodoksëve shqiptarë të kudondodhur, por edhe me veprimtari brenda trojeve shqiptare. Veçanërisht Patriarkana vepron në radhët e ortodoksëve shqiptarë në Turqi, Siri etj. me qëllim që të shpërngulen e vendosen në Greqi, ku nga qeveria greke u krijuan lehtësira të shumta si gjetje pune, strehim etj. në tokat e çamëve të dëbuar në vitet 1920 etj. dhe për t'i shfrytëzuar për qëllimet antishqiptare. Kjo së bashku me sultanin bashkëpunuan edhe për ndalimin e hapjes së shkollave shqipe në Turqi e territore shqiptare dhe shtimin e kishave greke e konsullatave greke në hapësirën mbarë shqiptare. Në vitet 1970 këto qarqe bënë çmos ta dëbonin priftin shqiptar që dërguan në Stambollit, duke nxitur sidomos ballistët shqiptarë e kosovarë atje si Qazim Prodan, Tahir Kolgjinin etj. tradhëtarë të arratisur ose mërgimtarë ekonomikë nga Shqipëria e trojet shqiptare nën ish-Jugosllavi. Patriarkana si lideri

shpirtëror i ortodoksisë dërgoi Janullatosin në 1991, edhe si kolonel i zbulimit grek, i cili "gjeti 1600 kisha të shkatërruara dhe vetëm 22 priftërinj të vjetër nga 400 më parë" dhe rindërtoi kishën ortodokse shqiptare (në fakt atë greke-H.L.) se ngriti 83 kisha, riparoi 140, restauroi 5 manastire, ndërtoi katedralen madhështore në Tiranë, sollti priftërinj grekë e dëboi ata shqiptarë, hapi shkollat e biznese greke, etj. Edhe shtetet myslimane hapën mbi 850 xhami, duke rivalizuar me Patriarkanën si në kohën e sultanëve, duke na sjellë edhe ISIS-in e hoxhëve e imamëve. Për këto qeveritë shqiptare u thanë bravo, se as perëndia s'e pat bërë! Erdhi edhe despoti rus Ciril te Janullatos për ta përgëzuar për bëmat ortodokse si shef shpirtëror në shekuj Rusia e madhe, për të vijuar edhe veprimtarinë agenturore të Putinit, i cili, siç shkruajnë mediat, ka paguar politikanë dhe diplomatët rusë kanë marrë pjesë edhe në protestat e PD! Qarku ruso-serbo-grek vepron si gjarpër i stërzgatur në trojet shqiptare kudo. Nuk ka kush ta mohojë kur kur veprimtari ia bënë mu sot, si dije dhe do vijojë në të ardhmen, siç tregojnë ngjarjet e tensionet në Ballkan e gjetkë.

QEVA ka krijuar edhe organizatat e saja informativo-propagandistike, siç janë "Instituti i Kërkimeve Vorioepirote" etj. Ky institut u krijua në 1975 me në krye Ksenofon Kondurin, i mërguar nga Korça, së pari, si qendër e diversionit politik armiqësor me veprimtari të theksuar kundër Shqipërisë dhe së dyti, si qendër e studimeve "shkencore" për të provuar me "fakte" përkatësitë greke të Epirit të Veriut dhe justifikuar tërë politikën shovene greke ndaj shqiptarëve.

Gjithashtu ka ngritur rrjetin e shtypit shovene antishqiptar siç janë: "Ipiritikon Mellon", "Epirotiçi Dhrasi", "Pirso Vorioepiriu" etj. Veç këtyre botohen edhe gazeta të tjera lokale, të cilat dalin pranë sillogjeve vorioepirote në qytete të ndryshme të Greqisë. Këto organe janë botuar e botohen 1-2 herë në muaj dhe me një tirazh të vogël. Në pararojë të shtypit shovene grek qëndron gazeta "Ipiritikon Mellon" (Anëtar i Epirit) që u drej-



tua nga Eleni Gagani, vajza e shovnit grek Athanas Gagani nga Pepeli i Gjirokastër. Kjo gazetë ka qenë e mbetet zëdhënësja më e fuqishme e rretheve shovene të Greqisë. Në artikujt e saj janë bërë e bëhen thirrje, akuzat, shpifje e fyerje për ndërhyrje të armatosur kundër Shqipërisë dhe përpjekje për të cenuar politikën e shtetit tonë në marrëdhëniet me Greqinë duke përcmuar shqiptarët e lartësuar Greqinë si qendra kulturore e botës. Gazeta "Ta Nea" në gjuhën greke që doli në Gjirokastër në 1998 si përfaqësuese e "Omonias" shkroi se "Himara e Vlora, është akropoli i helenizmit"! Në fakt, për shumë vite Himara u bë pika turistike më e vizituar nga deputetët e politikanët grekë të çdo ngjyre dhe utheshin me Bollanon e vet shpallur grek! Në 2003 atje shkoi me helikopter qeveritar edhe Janullatos! Gazeta "Llailko Vima" e botuesit greko-amerikan, Vasil Jatr, në tetor 1998 shkroi: "Çkërkojnë shqiptarët për Kosovën, kërkimë ne për Vorio Epirin, as më shumë as më pak. Këta kërkimë autonomi"! Askush nuk e pëshyty!

Rrethet drejtuese të lëvizjes vorioepirote herë pas here nxjerrin e shpërndajnë në radhët e vorioepirotëve edhe fletushka me artikuj të veçantë edhe trakte të ndryshme me përmbajtje fetare antishqiptare, jo pak prej të cilave janë hedhur e shpërndarë edhe në vendin tonë përmes ajrit, tokës, lumen-

je dhe diversantëve e vizitorëve në të kaluarën, ndërsa sot përmes lëvizjes së lirë të njerëzve të lëvizjes vorioepirote e të huaj. Në këtë fushë është dalluar sillogu vorioepirot i Janinës dhe në veçanti ai i rinjve.

Struktura organizuese e lëvizjes vorioepirote ndryshon në mënyrë të vazhdueshme, jo në thelb, por në përpjekje për të krijuar e përshtatur organizata të reja veçanërisht në radhët e të rinjve, vazhdojnë përpjekjet për njësimin bashkues të lëvizjetave në ShBA-Kanada me ato të Greqisë dhe me ato ilegale a legale brenda vendit tonë, për t'i parafunduar si një forcë e vetme e të fuqishme, jo vetëm për të mbajtur gjallë moralin e anëtarëve të këtyre sillogjeve por edhe për të nxitur shtimin e radhëve të tyre, për të rritur veprimtarinë dhe për t'u bërë jehonë në opinionin publik grek e ndërkombehtar mëtimeve të shoveneve grekë ndaj trojeve shqiptare.

Për këto qëllime shteti grek sidomos qysh pas çlirimit të vendit tonë në 1944 dhe në vijim ka bërë përpjekje të ethshme për ta mbajtur ngritur lart problemin e Epirit të Veriut, duke manipuluar, mashtruar e përdorur kartën e "lëvizjes vorioepirote" etj. në përputhje të plotë me interesat e kërkesat e politikës greke në vite në marrëdhëniet me Shqipërinë për të realizuar në momentin e përshtatshëm mëtimet armiqësore në trojet etnike greke në qiptare. Numri i pakicës greke në



Shqipëri nga 20-30 mijë vetë në kohën e socializmit reklamohej në propagandën greke si 400.000, që nuk do të arrijë kurrë. Sot qeveria greke bën çmos që pakica greke të qëndrojë në vendbanimet e saj e të përhapet në vend, duke e ndihmuar financiarisht për biznese e me pensione pleqërie, me qëllim që të mbajë ngritur politikën e saj ndaj trojeve shqiptare. Në një rast u shkrua se edhe në Fan të Mirditës paskish voieprote, ku PBDNJ mbronte të drejtat!

Për të joshur e kënaqur, ndikuar e përkrahur anëtarët e sillogjeve vorioepirote, shteti grek u ka krijuar disa lehtësi e privilegje siç qenë e janë ende në fuqi sot në kushte më të përshtatshme gjatë tranzicionit tragjik shqiptar. Të gjithë personat e arratisur në Greqi u trajtuan financiarisht e materialisht për aq kohë sa të shtetin punë e strehim duke i sistemuar vetë administrata shtetërore për gjetjen e vendosjen e tyre në punë e strehim. Fëmijët e vorioepirotëve i vazhdojnë studimet e larta pa kaluar nëpërmjet konkurseve, siç bëhet për studentët grekë dhe përqindja e pranimit të tyre nga këto shkolla e rrethe të larta është më e madhe në krahasim me vendësit. Gjatë qeverisjes së Papandreut në vitet 1980 këtë privilegj e gëzuan vetëm fëmijët e të arratisurve nga Shqipëria në Greqi pas vitit 1948 si dhe të arratisurit rishtazi në vitet e fundit. Fëmijët e vorioepirotëve nuk shkojnë ushtar ose përgatiten në reparte speciale ku doktorinohen siç tregoi rasti Kacifas edhe sot. Sillogjeve vorioepirote u njihet më parë edhe nga shteti grek e drejta për t'u lëshuar certifikata për punë, pension, dërgim të hollash në Shqipëri etj. Më vonë ky privilegj nuk iu njoh sillogjeve. Sillogjet vorioepirote financoheshin nga shteti përmes sektorit vorioepirot në MP. Jashtme greke në masën 700.000 dhrami në muaj në vitet 1980 të shek XX.

**Disa mësimë që duhet të nxirren nga provokacioni grek në Bullar për t'i vënë kufirin të Thana veprimtarisë grekomadhe**

Së pari, ky ishte provokacion i radhës i parashikuar mirë në rrafshin politik e ushtarak, pasi grupi i armatosur përbëhej prej 5 terrort-





Ndërtimet pa leje, marrin tapitë për truallin 1000 përfitues, sipërfaqet që legalizohen

Qeveria miraton një fond prej 105 milionë lekësh për kompensimin e 300 pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Në të njëjtin vendim është miratuar edhe kalimi i pronësisë për truallin mbi të cilin është ndërtuar. "Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas Zyrrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është 10 993,97 m<sup>2</sup> dhe vlera totale e kompensimit financiar është 105 224 873 lekë", thuhet në vendim. Gjithashtu, është miratuar kalimi i së drejtës së pronësisë, në favor të subjekteve përfituese për 633 prona me rreth 1000 pronarë. Vlera kompensimit financiar për pa-

# Agjencia e Kadastrës, 105 milionë lekë për 300 pronarë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër

suritë vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, e cila bën të ditur listën me përfituesit.

## TAPITË

Këshilli i Ministrave miratoi të mërkurën edhe kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të

legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre. Sipas vendimit të qeverisë, mësohet se për qarkun Elbasan (ZVRPP Elbasan, Peqin, Librazhd) janë pajisur me tapitë 163 persona, për

qarkun Durrës (ZVRPP Durrës) 24, për qarkun Tiranë (ZVRPP Tiranë dhe Kavajë) 174, për qarkun Fier (ZVRPP Lushnjë) 20, për Shkodrën 9, për qarkun Vlorë (ZVRPP Vlorë dhe Sarandë) 186, për qarkun Gjirokastër 45, për qarkun Lezhë 9, për qarkun

Kukës dhe për qarkun Korçë nga një. Këshilli i Ministrave urdhëroi Zyrrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Kavajë dhe

Kukës të regjistrojnë brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

(vijon nga nr 1 djeshëm)

BEHXHET	HAZEM	SHERMADH	500.0
ZARIF	QAZIM	DELIU	277.5
ELMAS	QAZIM	DELIU	351.3
MERITA	PETRIT	SALLA	178.2
KRISTAQ	KOST	ÇIPI	373.2
NDRIÇIM	ABEDIN	MURATI	239.4
ISMET	ABDULLA	HOXHA	258.3
ENVER	LATIF	ÇELA	241.5
ISLAM	MURAT	METALLA	327.9
RAMAZA	CAUSH	TABAKU	435.6
LEONARD	BEHAR	KOLA	289.8
NESTI	AHMET	XHAJA	340.5
ÇLIRIM	AHMET	XHAJA	253.1
TASIM	SALI	PLAKU	379.5
KUJTIM	ASLLAN	KRECI	324.0
DASHAMIR	FAIK	FERHATI	334.5
FLORI	NEXHIP	BEQIRI	331.2
JASHAR	ADIL	SALLA	375.6
ERMIR	JASHAR	SALLA	
BUJAR	NUH	GJELI	500.0
ENKLED	QEMAL	DUBALI	320.7
ZENEL	RRAPUSH	JAKUPI	72.0
BRUNO	KUDRET	ELEZI	78.0
ARBEN	ALUSH	SHOTI	500.0
DURIM	PULLUMB	BEGA	404.4
ENGJELL	PULLUMB	BEGA	449.1
XHEVDET	HAJDAR	SALLIU	378.6
KRISTO	HYSNI	GUNA	417.3
REXHEP	SHAHIN	HAKA	367.5
SHPËTIM	RRUZHDI	ÇEKU	500.0
REXHAI	KASEM	BASHLLARI	161.0
SHERBET	HALIT	BIXI	347.7
MYFTAR	REFAT	BIXI	500.0
AQIF	RAMAZAN	BIXI	463.5
NEVRUZ	RAKIP	BIXI	324.0

ARJAN	BEDRI	KARINA	376.2
BEDRI	HASIZ	KARINA	263.5
ALBERT	DEMIR	SULI	233.7
RAMAZA	RIZA	SHABANI	270.0
SERVET	NYRTEZA	ELEZI	500.0
HASAN	RESHIT	HARREMI	494.7
KADRI	AQIF	HIDRI	378.0
SHERBET	XHEMALI	SINANI	438.9
BARDHUL	SHERBET	SINANI	
MUHAMET	XHEMALI	SINANI	441.0
TAFIK	ZYLIF	ÇELMETA	482.1
HYSEN	BEHAR	KOLA	370.8
KUJTIM	SHEFQET	URUÇI	448.5
EMILHA	RAMAZAN	SALLIU	293.9
VATHI	DEMIR	IDRIZI	1094.4
YMER	RAKIP	TASHI	393.6
DRITAN	YMER	TASHI	500.0
YMER	RAKIP	TASHI	112.5
DRITAN	YMER	TASHI	328.8
LEONIDHA	HAMIT	BALLIU	347.4
SOKRAT	DHIMITËR	TOLI	343.5
MYFTINIA SHILBATER			246.8
FADIL	SHABAN	PREÇI	245.4
OLTJAN	BARDHYL	HOXHA	78.0
MYFTENIA TREGAN			288.6
BESNIK	REFAT	BLOSHMI	196.5
SAMI	BANUSH	PJETRI	419.7
FERIDON	XHEVAIR	ALLKO	321.3
MEHMET	QANI	HANA	321.3
VALBONA	NAZMI	GULASI	195.6
GEZIM	XHEMAL	KACA	300.0
MUHARREM	MUSA	ALLKO	352.6
YLLI	SHAHIN	KUKLI	420.6

HAXHI	MUHARREM	MERKURI	161.3
NIKO	DHIMITËR	GULASI	110.4
SYRJA	SEIT	FACJA	356.4
FITNETE	ISMAIL	SHTYLLA	318.6
VELI	XHILE	QYRA	370.2
DURIM	AHMET	ISMAILI	266.9
SHPETIM	ZENEL	KOÇIU	416.8
SALI	FILE	RUSTA	400.2
HYSEN	NURI	RUSTA	363.2
HYSEN	NURI	RUSTA	500.0
KADRI	ISMAIL	PAJA	174.3
SKENDER	MAHMUT	META	344.9
RRAPUSH	MESUT	SOLLAKU	500.0
SEFEDIN	IDRIZ	PEPA	479.4
ESMERALD	BAJRAM	SALLIARI	500.0
XHORXH	JANI	NIKA	
BASHKIM	NOVRUZ	MULELLARI	203.0
ALFRED	XHEVDET	SEFERI	256.0
ZYDI	REFIK	HALLI	448.0
MUSA	FEJZI	ELEZI	500.0
ALUFLOR SHPK			489.0
FLORIAN	QEMAL	MANSAKU	322.0
LILJANA	XHEBAR	CANI	500.0
ILIR	DIELL	CANI	
FATMIR	MEHMET	ASLLANAJ	234.0
DAJLAN	MEHMET	ASLLANAJ	
SKENDER	SULEJMA	SHAHINI	396.0
SHEFQET	AHMET	SHABA	363.0
FATMIR	VATH	MANCI	313.0
HASAN	HAMID	VEZI	260.0
RAMIE	SHABAN	ADEMI	
EDLIRA	FADIL	BERISHA	
LUAN	FADIL	ADEMI	
TRENDAFIL	FADIL	SHKOZA	416.0
SHABAN	LUFTA	KECI	500.0
LEONARD	FATMIR	MUCA	490.0
RUDOLF	FATMIR	MUCA	

ISMET	MALIK	LITA	245.4
BRUNO	RAMIT	PANXHA	157.5
FERIZ	XHELADIN	SINANAJ	155.1
ALBAN	HALIL	ÇERA	248.4
SURE	SHABAN	GERDECI	214.8
FERIDE	AHMET	GOXHAI	405.9
BLERIM	AHMET	KORTOÇI	466.2
GUXIM			
XHEMIL	REXHEP	IBRAHIMAJ	308.1
ARANIT	SALI	PERVANA	116.1
BASHKIM	KADRI	KANANI	
AZGAN	ALI	DUSHAJ	482.1
ARIF	ALI	DUSHAJ	
JANI	JORGO	AGORA	134.0
BUJAR	BILBIL	JATA	294.6
ANTON,KOL	KOL,SOKO	ZHABORJA	431.4
LUTFI	MUSTAFA	BALLGJINI	330.0
SULEJMAN	ISMAIL	KURTI	286.5
PERPARIM	XHELAL	MAVROKO	
HANE	AHMET	KOLOSHI	500.0
MUSTAFA	HAZIS	FISHTI	314.1
PËRPARIM	RAHMAN	NESIMI	255.9
SEKMAN			
FATMIR	HYSEN	SHUPLI	133.5
SHKELQIM	KAPLAN	BRAHILIK	500.0
FILIP	PJETER	PROGNI	14.4
TEME	MEHMET	PELUSHI	230.5
ZARIE	SHERIF	MARKU	140.6
SALI	MAHMUT	NOKA	228.3
DAN	MEHMET	HIDRI	419.7
ARBRI	SADIN	SAVA	251.8
KUJTIM	NEZIR	KURTI	500.0
LIRIE	ADEM	KURMETA	386.7
AGRON,MERI	JAKUP	REXHMAT	314.4
MELAIM	SHABAN	DELHAS	147.0
SHKELZEN	SADIN	SAVA	215.8
TAF	RRUSTEM	AHMATI	315.0
GASPER	MITER	PRABIBA	500.0
SAMI	SHAQIR	BRAKA	251.1
FERIT	RIZA		
JASHAR	FERIT	UKA	384.3
LULZIM			
HAXHI	IDRIZ	CERPJA	387.6
AGIM,DRITA	HAN	RAMAJ	357.2
INDRIT	AFRIM	LALA	347.7
REXHEP	VAIDIN	GJETA	306.0
VEBI	HASAN	MATRAN	178.5
BARDHYL	MYFTAR	KOÇI	275.1
RIZA	BANUSH	MISIRI	287.1
VATH	ALI	TARJA	410.0
TOM	MARK	PERKEQI	312.8
HAXHI	XHAFAER	DEMIRXHIU	278.7
BËSNIK	FEIM	DOKA	253.4
ZARIE	SHERIF	MARKU	140.6
SALI	MAHMUT	NOKA	228.3
DAN	MEHMET	HIDRI	419.7
HANE	AHMET	KOLOSHI	500.0

SHKUMBIN	ADEM	ISUFAJ	374.0
NAIM	VULLNET	DOBRUSHI	240.3
LUFTAR	LLESH	ARAPI	250.5
SERVET	FERUK	NELI	446.6
KUJTIM	HYSNI	CARA	269.0
BESIM,ZAIM	ZAIM,MUST	KASTRATI	415.7
REHAN	HAZIR	ISLAMAJ	284.7
BESIM	SALI	MENA	277.6
VELI	RESHIT	SKENDERI	313.0
RESHIT	ALI	SKENDERI	
ALFRED	MYFTAR	TAFA	500.0
MUHREDIN	BAJRAM	MYFTARLL	500.0
KASTRIOT	NAMIR	DEMA	176.0
FREDERIK	NAUM	BOJA	186.5
MAJLINDA	ASPI	BOJA	
PANDI	PASK	TRIFI	419.0
JANI	THOMA	BALLIU	185.7
MUHAMED	PETRIT	DIMNI	113.0
FEHMI	LIMAN	MUSTA	317.4
Harun,Nafije	REXHEP	MUSTA	
SAMI	VAHID	CARA	279.6
VASIP	HAMDI	TALLUSHI	380.0
AGRON	HASAN	MISIRI	27.3
GANI	OSMAN	SHEHU	357.0
MERUSHE	MURAT	MUÇA	
ANISA	ISA	MUÇA	25.0
ERVIN	ISA	MUÇA	
HAMIDE	MEHMET	RUÇI	25.2
ISUF	SKENDER	GJYLA	194.0
ANDREA	FERDINAND	LEKA	211.0
LULZIM	ISLAM	SARACI	400.0
FATOS	AZIS	BANI	295.0
ARDIAN	KAMBER	SEFA	257.0
KUJTIM	MYSLIM	LULJA	97.0
JANI	ILUJA	MAVROMA	438.0
ZUA	AVNI	SINANI	460.0
NEVRUS	TOMORR	SALIASI	453.0
SOKOL	BEXHET	DEMO	340.0
HAXHI	BRAHIM	MARKU	178.0
ILIR	BRAHIM	MARKU	
SKENDER	NAZIF	MERKAJ	240.0
NEIM	FERIT	KASHARI	237.0
ANASTAS	REXHEP	MARKU	234.0
LIRI	NUREDIN	MURATI	
SAMI	ARTAN	MURATI	
METHAT	ARTAN	MURATI	62.0
ILIR	AZEM	LUSHKA	37.0
LEFTER	KAPLAN	CANKA	30.0
ZAMIR	QEMAL	LLAZANI	113.0
ZEF	NDUE	HASANI	16.6
ARBEN	LAZER	GJERGJI	135.0
2	3	4	9
ARDJAN	GJON	FIRZA	343.0
FAIK	EMIN	PIRI	25.0
BUKURUE	TAIP	PIRI	
GEGE	PAL	DOÇAJ	500.0
SABAHEIDIN	RIFAT	HEBOVI	7.4
ELJAZ	ALI	ALUSHI	480.0
PJERIN	LAZER	LAZRI	276.0

SIRJAN	HASIM	ALUA	250.0
EDISON	FERIK	SELMANI	
NAIM	SHEFQET	DOMI	
FERIK	ARIF	SELMANI	
ARTUR	RESHAT	GUMBAR DHI	55.3
SKENDER	BAKI	BEKTESHI	
ARBEN	SPIRO	MEHILLI	
ARMIS	FAHRI	MEKA	
LEFTERI	TODI	BOZO	
QIRJAKO	PASKAL	KURETA	63.2
AVJON	ISLAM	DORZI	
AHTERE	NEKI	XHXHA	61.9
TATJANA	XHELAL	SINAJ	
HYQMET	HYQMET	ALIBESI	
ANASTASIA	VANGJEL	PITE	
FLORIAN	DHAME	PITE	
MIRSA	DHAME	PITE	
LAURET	NIKOLLE	LLESHAJ	
KUJTIM	BEDRI	BEQO	
SHPETIM	SHABAN	IDRIZI	
NATASHA	MYRTEZA	IDRIZI	
MARA	IVAN	MERXHUSHI	
VALERIA	HASAN	MERXHUSHI	27.9
TEFTA	MYZAFER	TUSHI	
DENIS	SULEJMAN	TUSHI	
DONALD	SULEJMAN	TUSHI	
ENGJELL	SHAHIN	FEJZAJ	18.5
SHEFIT	ADEM	TUSHA	
SHEFIT	ADEM	TUSHA	
DORIAN	TOMOR	DEMETJA	
FATOS	BAKI	YZEIRI	28.8
SHTJEFEN	RROK	ZOJZI	
ENDRI	NIKOLLA	BERATI	
MUHARREM	ELMAZ	DEZHGIU	
NDUE	ZEF	TOMA	41.5
HYSENJ	OSMEN	KORDHA	
SHPETIM	ZYBER	LILA	
GEZIM	ISA	GUÇE	10.5
BILBIL	SABRI	XHAFAERAJ	51.8
ALBERT	SEJDO	KAMBERAJ	
AGRON	GJYSHO	SHEHU	4.0
HATXHE	HAMIT	LIKSALA	
AGRON	GJYSHO	SHEHU	
HATXHE	HAMIT	LIKSALA	
HATXHE	HAMIT	LIKSALA	28.8

ASTRIT	MEHMET	AZIJAZ	10.7
MARJETA	SEFER	DOBI	
LUAN	SUBI	DOBI	
VEBI	NURI	VARROSI	
ARDIAN	THOFAN	BEZHANI	

JONIDA	MAKSIM	BAJRAKTA	36.2
EDLIRA	KLUTIM	LLOHA	
MAKSIM	XHEVDET	LLOKA	
HAMIDE	ZENEL	BASHAJ	
ABEDIN	HEKURAN	KALEMI	
VELI	SELAM	MUSTAFAR	
SOKRAT	MEÇO	AMATAJ	
GEZIM	KOSTANDI	SHARRA	
SPIRO	THIMI	THEMELI	
MIMOZA	RAKIP	THEMELI	
LILJAN	ELJAZ	PICOKU	
PAQIZE	QAZIM	PICOKU	
SOSE	SABRI	ISLAMAJ	

LUMTURI	NAMIK	VAKO	23.6
THELLEZE	NAMIK	THANO	
MIRELA	EDUART	ISLAMAJ	
ARTA	NAMIK	SILAJ	
KLEA	ASTRIT	ISLAMAJ	
ALDO	ASTRIT	ISLAMAJ	
SOKOL	ISLAM	SULA	
KINO	DALAN	BUXHELI	
GAZMENT	ESTREF	DIBRA	
AGE	PJETER	NIKAJ	
GRETA	VANGJEL	HOXHA	
JULJA	VANGJEL	MTRUSHI	
VELI	SALIKO	BARDHI	
SULEJMAN	ZYBA	LUSHI	
ROVENA	RESHAT	GOLEM	

DELI	HAREDDIN	ZENELAJ	48.1
SOKOL	MURAT	TOLULI	63.7
PLURENT	LAVDOSH	YZERI	
HASAN	RAMADAN	DISHA	

ILIR	YLLI	VELESHNJ	6.0
------	------	----------	-----

GAZMIR	MALUSH	MALUSHI	51.3
GAZMIR	MALUSH	MALUSHI	
BRIKENA	MUJARREM	POJANI	
ELIDA	NEZIR	MURATI	
MIMOZA	NEZIR	MURATI	
VJOLLCA	NEZIR	MURATI	
MERITA	NEZIR	MURATI	
HYJNI	MUÇO	BEDO	
JETA	FETI	KAMENICA	
EVIS	ALI	KAMENICA	
BRIKENA	ALI	KAMENICA	
HYSNI	MUÇO	BEDO	

NURI	REFAT	MUÇO	13.3
NIKO	VASIL	QYRA	11.6
NURI	REFAT	MUÇO	
NIKO	VASIL	QYRA	

"DUKA 17" SHPK			25.0
NAIME	XHEMAL	MUSTA	
FERID	RUZHDI	MUSTA	
VALENTINA	ALI	SCHWARZ	
DAUT	ASLLAN	MURATI	
LUMTURI	SABRI	MURATI	

ERMIR	ISUF	CAKONI	
XHEMAL	HALLIL	MATO	

XHELADIN	HASAN	ZAIMI	18.0
----------	-------	-------	------

SELFO	HYSEN	MAHMUTI	96.4
ILIR	ABDI	NEZIRI	

YLLI	DALIP	ALUKU	20.0
FANIKA	ILIA	ALUKU	

DONIKA	REXHEP	MYRTO	7.9
ARBORA	NAMIK	GOGA	
XHULJO	NAMIK	GOGA	
VALENTINA	BRAHIM	GOGA	
DONIKA	REXHEP	MYRTO	
ARBORA	NAMIK	GOGA	
XHULJO	NAMIK	GOGA	8.6
VALENTINA	BRAHIM	GOGA	

ENVER	XHEMAL	HYSA	20.6
-------	--------	------	------

ISLAM	MEHDI	QIBINI	7.3
VIOLETA	THOMA	QIBINI	

ARBEN	SABRI	MANELLARI	58.8
BILBIL	HAXHI	SHEHAJ	
LLAZAR	RRAP	NASKA	

LILJANA	OSMAN	HASMAD	450.4
AVDI	SHABAN	HASMAD	
BAJRAN	HAZIR	VUTHA	293.6
SADIE	HALIL	AGA	205.0

AGIM	IBRAHIM	HILAJ	323.7
EDUART	XHAVIT	VRAJA	275.1

DHURIM	ENVER	KADRUI	234.9
--------	-------	--------	-------

ILIR	SKENDER	HYSEN	422.4
SKENDER	MERSIN	HYSEN	

FERDINAND	VAIT	ELMASLL	301.3
-----------	------	---------	-------

FATMIR	DAN	KALOSHI	63.9
SHEFKI	DAN	KALOSHI	71.7

BASHKIM	GANI	XHEPA	243.0
---------	------	-------	-------

SHYQERI	RIZA	PALLOSH	296.1
---------	------	---------	-------

ARJAN	ASLLAN	MUCA	297.0
-------	--------	------	-------

BARDHOK	DOD	PRENDI	451.8
SYRJA	ISLAM	HURDHA	254.4

FERIT	ALI	SETA	311.1
-------	-----	------	-------

ARBEN	DAN	BALLA	339.3
ZUA	XHEMAL	KALICA	207.3

FATMIR	HAMZ	TOTA	483.9
--------	------	------	-------

GEZIM	HAMIT	GJOKA	292.8
BESIM	AHMET	MUSTEQJA	286.2

AGRON	LATIF	DAJA	250.8
-------	-------	------	-------

SAMI	HAMDI	LLESHI	305.1
------	-------	--------	-------

BARDHUL	QERIM	ISTREFI	315.6
RUSHIT	XHEMAL	SKARRA	173.1
SHABAN	SELIM	DOMI	280.2
PRANVERA	ISLAM	SHEHU	36.6

PJETER	PRENG	VATA	289.8
PJETER	PRENG	VATA	289.8
REXHEP	RAMAZAN	GUXHA	340.5

ERNEST	HYSEN	BALA	286.2
--------	-------	------	-------

MALIQ	RESHIT	BRAHJA	125.2
-------	--------	--------	-------

RESMI	RIZA	ALMADHI	30.0
-------	------	---------	------

HYSNI	XHEMAL	MERJA	292.5
-------	--------	-------	-------

ELMI	FADIL	ALLMUCA	114.6
------	-------	---------	-------

MEHMET	VESEL	BAJRAN	190.5
--------	-------	--------	-------

QEMAL	MEXHIT	TROKSI	346.5
-------	--------	--------	-------

ENGJELUSH	MENSUR	MENSURI	303.9
-----------	--------	---------	-------

BILAL	HAKI	GJUZI	408.3
-------	------	-------	-------

LULEZIM	ARIF	HOXHA	316.8
JUXHIN	LULEZIM	HOXHA	
ERJOLA	MUSA	HOXHA	

SHKELQIM	SULEJMAN	DRIZA	317.4
----------	----------	-------	-------

ALGERT	TELHA	NOZLLI	311.1
--------	-------	--------	-------

QEMAL	SALI	BARDHI	179.1
-------	------	--------	-------

SHKELZEN	DESTAN	XHAFERAJ	302.4
----------	--------	----------	-------

ARDJAN	HAXHI	SHIMA	287.1
--------	-------	-------	-------

BARDHYL	YMER	BRAHJA	500.0
---------	------	--------	-------

SULEJMAN	AVDI	VATA	238.8
----------	------	------	-------

BUJAR	ABDYL	HASMADHI	200.4
-------	-------	----------	-------

XHUVAN	DERVISH	CEKA	415.8
--------	---------	------	-------

AHMET	MUJARREM	KODRA	104.1
MURAT	MUJARREM	KODRA	269.1

SKENDER	XHEMAL	GONA	474.3
ILIR	OSMAN	SELIMJA	253.8

NEXHAT	IMER	SHEHI	387.0
VASILIKA	FANI	KOLA	

MILTADH	SPIRIDHON	XHOLI	208.0
---------	-----------	-------	-------

POLIKRON	CANO	BALLAJ	183.0
MARLIND	HARALLAMB	SHOLLA	500.0
ALBOREN	ILIR	ALIAJ	500.0

TAULANT	XHEZMI	SEJDI	445.0
---------	--------	-------	-------


HAVA	HYSEN	KAMBERI	161.0
ADRIATIK	ZENEL	LULA	162.0

(vijon)

E DIEL  
28 Prill  
2019



# Si do të jetë muzeu i Françeskanëve



Franca përballë Notre Dame

NGA AARK. GJON RADOVANI

**P**rovinca Franceskanë ka mbi supë një trashëgimni materiale dhe imateriale shumë të madhe dhe tepër të rëndësishme jo vetëm për vetë provincën, por edhe për mbarë Shqipërinë, rajonin dhe Europën.

Franceskanët e mëdhe shqiptarë kanë shënuar hapa tepër të rëndësishëm në letërsi, gjuhësi, filozofi, memuaristikë, folklor, etnografi, antropologji, histori, arkeologji, muzeologji, arkivistikë, diplomatikë, arkitekturë, muzikë, pikturë, etj. Mjafton të përmëndim disa nga emrat e tyre, si Leonardo de Martino, Gjergj Fishta, Anton Harapi, Vinçenc Prenushi, Justin Rrota, Zef Pllumi, Shtjefen Gjeçovi, Benard Palaj, Donat Kurti, Bene-

dikt Dema, Marin Sirdani, Pal Doda, Ambroz Marlaskaj, Martin Gjoka, Lin Delija, për të imagjinuar pasurinë e madhe dhe të pacmueshme kulturore që këto etër të mëdhenj të fesë dhe të kombit na lanë si trashëgimni.

Rrugëtimi tjetër paralel, është ai i një grupi intelektualësh, artistash dhe artdashësish, por mbi të gjithë qytetarësh, të bindur se prona e përbashkët e një kombi duhet të jetë e paprekshme dhe duhet të vihet në shërbim të gjithë njerëzimit, grup intelektualësh që para një dekade u mblodh nën siglën e Art Union Albania. Ky subjekt përfaqëson më së miri, dëshirën dhe thirrjen e brendëshme të intelektualëve dhe artistëve të vërtetë dhe të paburë të çdo kohe, që sakrifikojnë kohën e tyre si dhe mjetet e tyre financiare për ti shërbyer të mirës së përbashkët për ti kthyer dinjitetin historisë dhe kulturës së vëndit.

Dua të huazoj këtu strukturën e një shprehjeje të famshme të

Shën Nënë Terezës që thotë: "Nëse nuk mundni të bëni gjëra të mëdha, bëni gjëra të vogla me dashuri të madhe" për të dalë në një konstatim, që mjerisht nuk është vetëm i imi se: "Të bësh gjëra të mira në Shqipëri duhet një mundim tepër i madh". Mjerisht ky është realiteti shqiptar. Ky është destini i një kombi që nuk ka memorie historike, i një kombi që pranon të keqen dhe në vend që ta luftojë atë, përpjet të adaptohet për të përfutuar nga situata.

Duke u marrë me të keqen dhe jo me të mirën, popuj të tillë arrijn në një vobekëti shpirtërore dhe mendore, aq sa i lejojnë vetes të mos vlerësojnë as vepra dhe figura të tilla si të mëdhenjtë e françeskanëve shqiptarë, që më në fund, tre dekada pas rënies së diktaturës, do të gjejnë në zëmëren e provincës, në qendrën e Shkodrës, një vend narracioni publik dhe një platformë komunikimi me shoqërinë.

NGA ANDI PASTEFANI

**K**atedralja e Parisit, siç e shohim sot, i dedikohet në përgjithësi punës së arkitektit restaurator Viollet-le-Duc (1814-1879). Ai së bashku me Jean Baptiste Lassus punuan për restaurimin e katedrales nga 1845 deri më 1864. Stili origjinal i Katedrales së Parisit (1163 - 1351) ishte ai Gotik. Viollet-le-Duc e konsideronte këtë stil Racional dhe shprehje perfekte e një shoqërie demokratike. Për të restaurimi nuk ishte vetëm rindërtimi i ndërtesës por arritja e unitetit stilistik origjinal të saj. Viollet-le-Duc restauroi interiorin në mënyrë të plotë për herë të parë. Shtiza që u dogj më 15 prill 2019 ishte krijimi i Viollet-le-Duc. Me anën e saj lartësia e Katedrales mbërriti 96 metra. Ashtu e hollë, shtiza të jepte idenë, se shponte qiellin drejt Zotit. Ky ishte qëllimi i arkitekturës Gotike të objekteve fetare. Pavarësisht se metodat e tij të restaurimit konsiderohen sot shumë të lira, personale dhe të debatueshme, ai shpëtoi shumë ndërtesa mesjetare nga shkatërrimi. Restaurimi i Katedrales së Parisit konsiderohet kontraversal. Megjithatë, Viollet-le-Duc-përveç se njihet si pionier në restaurimet-arkitektonike, ngelet edhe njohësi më i mirë i arkitekturës Gotike. Zjarri i 15 Prillit 2019 e vuri Francën para një dileme, që të rikonstrukttojë Katedralen dhe veçanërisht shigjetën në mënyrë rigorozë, apo të bëjë një adaptim sipas kërkesave dhe teknologjisë së kohës. Fati i shigjetës do përcaktohet nga rezultatet e një konkursi ndërkombëtar të saposhpallur. Franca ka një traditë të rinovimit të monumenteve të vjetra, bile duke futur edhe elemente të arkitekturës moderne, siç është rasti i piramidave të Luvrit.

→ Vizion në faqen 14

**Në këtë numër: WIKTOR BRUMER NGA LEONARD ZISSI, FAZLLI HALITI, MEHMET ELEZI, GJON RADOVANI, ANDI PASTEFANI, MYSLIM PASHA ETJ. . .**

A

ARKITEKTURË

Ndërtimi i këtij muzeu është një sipërmarrje kombëtare, prandaj involvimi në procesin e punës për konceptimin e brendisë së tij kërkon një gjithpërfshirje institucionale dhe involvimin e subjekteve të specializuara. Faza e projektimit arkitekturor ka përfunduar dhe mbi këtë fundament mund të punohet me shpejtësi dhe seriozitet për hartimin e konceptit përfundimtar të muzealizimit të kësaj trashëgimie të madhe kulturore.

# Ky është koncepti arkitekturor i Muzeut të Kulturës Françeskane

NGA ARK. GJON RADOVANI

Vijon nga faqja 13

Ndërtimi i këtij muzeu është një sipërmarrje kombëtare, prandaj involvimi në procesin e punës për konceptimin e brendisë së tij kërkon një gjithpërfshirje institucionale dhe involvimin e subjekteve të specializuara.

Faza e projektimit arkitekturor ka përfunduar dhe mbi këtë fundament mund të punohet me shpejtësi dhe seriozitet për hartimin e konceptit përfundimtar të muzealizimit të kësaj trashëgimie të madhe kulturore. Rëndësia kombëtare e muzeut sugjeron krijimin e një grupi pune të një niveli shumë të lartë kombëtar dhe ndërkombëtar, i cili në bashkëpunim me provincën dhe me grupin e punës së provincës të trajtojë me përgjegjësi të madhe brendinë e muzeut por edhe strategjinë e gjestionit të tij në të ardhmen, duke përkujtuar që në këtë fazë bashkëpunimin me entet shtetërore dhe me partnerët strategjik të mundshëm.

Hapi i parë në drejtim të pasurimit të muzeut me vepra me vlerë kombëtare u bë nga Art Union Albania, me dhurimin e 104 veprave të piktorit Lin Delija. Eshhtë po i njëjti grupim, që një rrugëtim të mundimshëm dekadën e fundit kërkojë me këmbëngulje të gjitha rrugët legjitime për vlerësimin e figurave të artit franceskan, në rastin konkret të përfaqësuar nga mjeshtri i madh i artit figurativ, Lin Delija. Ekspozita shumë dinjitoze u organizuan me sakrificë, duke i bërë ballë injorimit dhe mosmbështetjen si nga instancat shtetërore, ashtu edhe nga ato subjekte, që kanë si objekt të punës së tyre promovimin e kulturës. Këtu kujtojmë ekspozitën "Rrugëtime paralele" organizuar në Muzeun Historik Kombëtar, atë "Lin Delija mes sakrale dhe profanes", organizuar me rastin e vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri, ekspozitë e hapur në Galerinë e Arteve Tiranë, atë "Fede e pittura di Lin Delija 1926-1994" organizuar me rastin e konferencës "Shqipëria në arkivat e propagandës Fide" në Universitetin Urbanian të Vatikanit, si dhe botimin e albumeve përkatëse mbi veprën e këtij mjeshtri të transkriptimit të shpirtit njerëzor në kanavacë.

Për këtë qartësi mendimi dhe besimin në rëndësinë e veprave për të mirën e përbashkët e ndej për detyretë si shpreh një falenderimin të veçantë të gjithë bashkë-



rrugëtarëve të mi: A. Ndreca, P. Asllani, R. Beluli, A. Alikaj, H. Bele, A. Stajka, E. Milaj, etj. Pa punën dhe mbështetjen e tyre, suksesi i këtij misioni do të ishte i rrezikuar. Sot duhet të jemi të gjithë të lumtur, që më në fund në 25 vjetorin e vdekjes së mjeshtrit Delija, po arrijmë ta kthejmë atë në shtëpi me dinjitetin që i takon. Përpara se të arrijmë në këtë stacion janë bërë tentativa të shumta për të hedhë dritë mbi këtë art. Vitet e diktaturës kanë qënë mizore për artin e lirë, por të pakten kanë qënë në harmoni me ideologjinë e represionit dhe dhunës në të cilën bazohet kjo ideologji e krimin. Absurdë dhe alogjike është sjellja ndaj së vërtetës në art dhe histori gjatë tre dekadave të fundit në demokracinë "alla albanese". 23 vepra të autorit në fjalë ju dhuruan Galerisë Kombëtare që para të vitesh nga Erika Schtutz dhe Armando Nicoletti. Asnjëra nga ata nuk e pa dritën e diellit, derisa Art Union inzistoi në përfshirjen e tyre të pakten në një ekspozitë provizore. Në keto kushte e ndjeje ti kërkoj zyrtarisht Ministres të Kulturës, e cila na ka ndëruar me pjesëmarrjen e saj në këtë event, që të gjykojë mundësinë e ekspozimit të këtyre pikturave në këtë muze këtu në Shkodër në mënyrë permanente.

Rëndësia e këtij muzeu, siç e përmenda edhe më lart e kalon përmasën e provincës franceskane dhe merr një dimension sa kombëtar aq edhe rajonal dhe evropian. Kombëtar, sepse shkenca, arti, letërsia, e prodhuar nga yjet e fretëve shqiptare i përket mbarë kombit dhe refleksion gjithë pasurisë shpirtërore të kombit shqiptar.

Rajonal, sepse fretin kamë një dimension përtej atij kombëtar. Vetë provinca është e Shqipërisë dhe e Malit të Zi dhe së fundmi evropian, sepse dogma, filozofia e mendimit dhe veprimi franceskan si edhe shkollimi i tyre ka patur gjithmonë dimensione evropiane.

Duke ardhur më në fund tek projekti arkitekturor i muzeut, dua të theksoj fillimisht aspektin urbanistik dhe vëndndodhjen e tij në qendër të qytetit të Shkodrës, në rrugën kryesore pedonale. Ku lokacion i krijon muzeut një aksesshmëri optimale si për vizitorët këmbësorë ashtu edhe për ata të motorizuar, të cilët do të kenë një mundësi parkimi në një parkim privat dhe publik të nëndheshëm në brendësi oborrit të Kuvendit Franceskan, që do të riforullohet i gjithi, duke krijuar një oazë urbane të niveleve më të larta bashkëkohore. Riformulimi i Kuvendit parashikon ndërtimin e strukturave të reja për kuvendin e fretëve, kurien, salla multifunktionale për konferenca dhe evente si dhe modernizimin e teatrit aktual, duke krijuar hapësirat e facilititë, që për momentin janë deficitare. Formatimi i sheshit përpara kishës do të krijojë një hapësirë publike shumë dinjitoze duke shmangur trafikun e motorizuar me një nënkalmi i cili njëherësh jep edhe mundësinë e hyrjes dhe daljes nga parkimi nëntokësor. Kjo inisiativë do të bëhet në bashkëpunim me bashkinë e qytetit të Shkodrës.

Koloriti dhe gjuha e projektimit arkitekturor është në harmoni



me filozofinë e këtij urdhëri: e thjeshtë, transparente, komunikuese dhe logjike. E vjetra do të rikonstruktohet me të gjitha normat dhe rregullat e një restaurimi korrekt, ndërsa rindërtimet dhe ndërtimet e reja do të shprehin racionalitetin dhe harmoninë estetike bashkëkohore duke mbështetur dhe suportuar të vjetrën dhe historiken.

Vetë muzeu i kulturës franceskane do ketë një sipërfaqe prej 1.290 m<sup>2</sup> si dhe një oborr të brëndshëm prej 270 m<sup>2</sup>, i cili do përdoret si për ekspozim ashtu edhe për kafeterinë e muzeut.

Nga këto sipërfaqe 600 m<sup>2</sup>, të shpërndara në tre kate, do të restaurohen, 540 m<sup>2</sup> të shpërndara në dy kate, do të rindërtohen dhe 150 m<sup>2</sup> do ti nënshtrohen një riorganizimi total.

Muzeu do të synojë :

- Transmetimin në mënyrë të qartë dhe të patjetërsueshme të frymëkës dhe shpirtit të dogmës kristiane dhe të filozofisë franceskane në përfaqjen e problemeve dhe situatave të jetës.

- Përkrahimin me vërtetësi akribike të historisë dhe të produktit religjioz, artistik dhe shoqëror që Provinca Franceskane e Shqipërisë ka dhënë në zhvillimin e vendit.

- Të karakterizohet nga një didaktike e thjeshtë dhe e qartë e transmetimit të mendimit dhe të mesazhit të ekspozateve tek shikuesi.

- Të ofrojë një pikë takimi dhe kontakti për studiuesat, që kanë të domosdoshme thellimin e studimit me materile suplementare.

- Të lidhet me të gjithë rrjetin e muzeumeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të njëjtës natyrë.

- Të jetë i aksesueshem online nga cdo vënd i botës nëpërmjet portalit të tij, i cili duhet të jetë i thjeshtë, logjik dhe funksional.

- Të ofrojë përcveqerjeve bazilare edhe të gjithë fasilitetet shtesë të nevojshme për vizitorët me aftësi të kufizuara në ecje, në shikim dhe në dëgjim.

- Të jetë i pajisur me të gjithë sistemet mbrojtëse, dhe të ndërhyrjes së shpejtë për mbrojtje nga zjarri, për urgjencë shëndetësore, për rastin e katastrofave natyrore, etj.

- Të synojë krijimin e një sistemi dhe modeli ekonomik i cili pas një "shtytjeje" fillëtare nga ana e Provincës ose/dhe të shtetit po të donatërëve të tretë, të shndërrojë projektin në një projekt autofinancues.

Shkodër, 11.04.2019









P

POEZIA

Poeti i njohur vjen me një poemë të këndshme me karakter kozmogonik, duke e shpërndarë shqetësimin e tij human drejt eterit të pafundmë. Kthjelltësia e ndjenjës dhe kujdesi me të cilën trajton figuracionin e përshfaqin si një autor, që gjithmonë kërkon parametrat shumë të lartë nga vetja...



NGA FAZLLI HALITI

. Poemë .

U zhduk  
Pa pritur graviteti.  
Mjerë Njutoni,  
Mbeti pa ligjin themelor.  
Humbi gjeninë  
Gjeniu i gjorë...  
\*\*\*  
Tokës i iku gjithçka, i fluturoi.  
Edhe një pupël s'e tërheq dot po të dojë,  
Ikën ujërat, pemët, bari, pyjet.  
U shkulën shtëpitë,  
Burgjet, kështjellat.  
Gjithçka u bë muzeale.  
Fluturuan si pula në kozmos rrokaqiejt...  
Gjithçka tokësore mori kozmosin përjetë.  
Sendet dhe gallela u zhvendosën në kozmos përjetë.  
\*\*\*

Pellgje  
Rrëkera,  
Përrenj, lumenj,  
Dete, liqene, oqeanë pezull.  
Pezull qiejve kozmikë;  
Pezull njerëzit,  
Kozmonautë në galaktikë...

S'ka më ujëra me kaltërsi idilike.  
Ka vetëm kthjelltësira.  
Kaltërsira kozmike.  
Fëmijët me krahë fluturues,  
Pleq pa rrudha, pa thinja.  
Njerëz  
Me dhëmbë dekorativë,  
Kafshë me dhëmbë dhe brirë butaforikë...  
Skifterë me kthetra, me sqepa atavikë...  
\*\*\*

Pezull vilat.  
Lanë mbi tokë çatitë.  
Nuk duhen më.  
Në kozmos s'ka shi.  
S'bie breshër;  
S'ka stuhira, dëborë, akuj, rrufera gjëmuese...  
Burgje, kështjella turistike,  
Dekore pluskuese.  
\*\*\*

Në kozmos ikën gjithashtu  
Akropoli, Koloseu, Kulla Eifel.  
Piramidat e Egjiptit;  
Koloseu,

Kulla Eifel,  
Mrekullira mbi tokë,  
Mrekullira në kozmos.  
Të njohura për kohërat,  
Për yjet,  
Planetët, botërat, qiejt kozmikë.  
Gjithçka vërtitet e përjetshme.  
Zoti u bë me shokë.  
S'është më unikal.  
Në kozmos s'është më  
I përjetshmi i vetëm i qiejve, gjithësisë,  
Edhe njerëzit janë të përjetshëm, si ai,  
Shokë të Zotit  
Perëndisë,  
Jehovait.  
Edhe Krishti  
S'është më bir i vetëm qiellor.  
U bë me vëllezër, me motra plot.  
Engjëjt u shumuan me fëmijë engjëllorë.  
Po Djalli?  
Djali mbeti i vetëm në tokë,  
Mbret i të vdekurve që i vdiq vetë,  
Të vetmin që toka s'e la të fluturonte.  
Të djallëzonte nëpër planetë.  
Të shejtanëzonte.  
Kozmosi plot pyje, bar, kullota,  
Përjetësisht të blerta, përjetësisht të pa-  
prekura.  
\*\*\*

Peshqit,  
Shpendët,  
Zvarranikët  
Fituan përjetësinë.  
Fituan statusin e perëndive antike,  
Ata janë perëndira.  
S'e pozojnë aspak perëndinë.  
Qengji, ujku,  
Ecin bri njeri - tjetrit, qiejve, hapësirave  
kozmitike;  
Ujkut s'i shijon më mishin,  
Ushqehet me përjetësi.  
Është kozmik.  
S'ka uri.  
Qengji s'pi sisë,  
Delja s'ha bar.  
Çlodh sytë lëndinave qiellore.  
Është perëndeshë e bardhë.  
\*\*\*

Bari jeshilon përjetësisht.  
S'ushqehet me plehra.  
S'i hahen plehrat organike.  
Kozmikët nuk hanë,  
Nuk pinë,  
Nuk marrin frymë.  
Fshatarët nuk korrin,  
Nuk mbjellin.  
Gruri,  
Misri,  
Përjetësisht me kallinj floriri.  
Drithërat kozmikë nuk korren,  
Nuk vilen,  
Nuk shkoqen,  
Nuk shihen.  
Zogjtë, perëndira cicëronjëse  
S'çukasin kokrra gruri, misri.  
Ushqehen me thërrime përjetësie.  
Skifterët  
Përqafohen me laureshat.  
Rrinë pezull krah njëri-tjetrit, në hije.  
Dallëndyshja s'i ha mizat, karkalecat.  
Ushqehet  
Me cicërima;  
Bretkosa  
S'i ha fluturat koloristike.  
Ushqehet me kuakje,

Gjarpri si ha bretkosat,  
Ushqehet  
Me pafundësi;  
Bretkosa, gjarpri, flutura  
Pluskojnë në kaltërsi.  
\*\*\*  
Njeriu kozmik,  
Barinjët kozmikë  
S'i mjetin lopët delet, dhitë kozmike.  
S'pi qumësht njeriu kozmik  
Është i përjetshëm,  
Është zotnjeri si zotat qiellorë.  
Zotat  
Me prejardhje tokësore  
As hanë, as pinë.  
S'janë

Si perënditë e Olimpmit.  
Perënditë e Olimpmit  
Kanë ngrënë kurbane mitikë.  
Gjinjtë e lopëve, deleve, dhive  
Fryhen, pikojnë qumësht kozmik.  
Pikat e qumështit  
Bëhen  
Yje.  
Krijojnë rrugë të reja qumështi në hapësirën  
e madhe.  
Rruga e qumështit s'është më e vetme.  
Kashta e Kumtrit s'është më unikalë.  
\*\*\*

Po bajgat?  
S'ka bajga qiejve kozmikë.  
Lopët, delet, dhitë janë perëndesha,  
Nuk kullosin, nuk hanë.  
Perënditë s'bëjnë jashtëqitje.  
Kozmosi s'bie erë.  
S'ka bajga,  
Pëgëra,  
Plehra,  
Kakërdhi...  
Zot.  
Mos i zërë hundët kot.  
Kozmosi ka vetëm yje dhe diej...  
Yjet dhe diejt bien erë rrezesh, erë dritë.  
Peshku i madh s'e ha të voglin.  
Qiejt gjithçka e kanë të madhe.  
I madhi s'e ha dot të madhin,  
Bëhen kuaj të një karroje,  
Qe të një qerreje.  
Kacafyten, shkatërrohen.  
Krijojnë harmonira qiellore.  
Harmonitë qiellore, -  
Harmonira absolute?!  
Ja  
Bretkosa dhe gjarpri  
Notojnë kaltërsive krah për krah.  
Gjarpri i mban iso kuakjes.  
S'i shkon mendja të hajë.  
Shijon  
Kuakjen e saj;  
Bretkosës s'i kujtohet të ketë ngrënë flutura.  
I shijojnë ngjyrat e bukura.  
Flutura. -  
Perëndeshë larashe  
Si, si!?  
Flutura perëndeshë?!  
Çoç të pandehnim Perëndi!  
Flutura dhe perëndia  
Pranë njëra-tjetrës.  
Perëndia i fut krahun flutur-perëndeshës.  
I bie kozmosit kryq e tërthor.  
Yjet e shoqërojnë me dritë,  
Me shkëlqim yjor...  
\*\*\*

Kozmosi s'ka të vdekshëm si toka.

Të vdekurit  
I lind, i rrit dhe...  
I ha toka.  
Kozmosi s'ka pika horizonti,  
S'ka kufi.  
Edhe jeta është e pakufishme.  
Është e përjetshme si ai...  
\*\*\*

Bagëtia-perëndeshë  
S'e ha blerimin.  
Njeriu -  
Perëndi,  
S'i ha frutat.  
Kozmikët nuk hanë,  
Vetëm shikojnë bukuritë me sy.  
\*\*\*  
Pylli  
Është perëndi shushuritëse.  
S'e rrallon sharra, sëpata.  
Kozmosi ka diej përndritës.  
Kozmikët  
S'përdorin zjarre.  
Sëpata zbardh përjetësisht tehun,  
Sharra zbardh dhëmbët me të madhe.  
\*\*\*

Krishti-  
Biri i Zotit.  
Po Zoti, vetë  
Biri i kujt është?



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte hapur me vizatimin e realizuar nga një piktor i njohur "Stefos" (Stefan Taçi) në Paris kushtuar Notre-Dame. Puna e tij në pastel e realizuar në vitin 2001 ishte një homazh yni për katedralen e famshme, ofruar bujarisht nga artisti, që përbënte dhe një simbol në vetvete. Autori pati pak ankese për mungesën e pak detajeve përshkruese, por që me mirësjelljen e vet natyrale i kaloi të gjitha këndshëm.

Shkrimi kryesor iu la një përshkrimi të hollësishtëm të shqiptarëve të Zarisë, realizuar në vitin e largët 1892, kohë kur një prift polak Marcin Czermski (Marçin Cerminsji), në kuadër të vizitave të tij misionare kishtarë katolike që bëri në Ballkan, udhëtoi drejt Shqipërisë dhe Dalmacisë, territor ky që sot bën pjesë në Kroaci, Duke lëvizur në rugët e Zarisë, që në atë kohë ishte kryeqytet i Dalmacisë, nga fytyrat ai dalloj se në atë qytet banonin shumë shqiptarë. Kjo tërhoqi vëmendjen e tij dhe për këtë u angazhua të përcaktonte origjinë e tyre, shkruan studiuesi i njohur Leonard Zissi, që e ka përgatitur shkrimin nga polonishtja...Si zakonisht patëm pak probleme me karakteret e vështira që layout ynë për shkak të menefregizmit të lindur sërish nuk i rregulloi. Për fat u kapën në momentin e duhur. Vetë redaktori shtoi një shkrim për marrëdhënien Shqipëri-Kosovë në kulturë duke marrë një lloj frymëzimi nga një memorandum i ri shtesë në kulturë mes dy vendeve tona. Një mal me dokumente mes vendeve tona. Eshhtë pak për të qeshur sepse nëse themi vellezër me kosovarët përse duhen dokumentet dhe kaq shumë marrëveshje... Autori shtoi se pengesa e parë mbetet gjitha e bashkëpunimit por mund të shtohen edhe elementë të tjerë. Ka gjithnjë e më shumë personazhe të cilët mundohen të arrijnë kontributet e mëdha që janë bërë në të dy anët e kufirit për identifikime të njëjta, ka kinse kompetentë që pretendojnë se Shqipëria është munduar të arrijë historinë e Kosovës dhe jo pak që përfllasin njerëzit e Kosovës në Shqipëri.

Në këtë numër u mbyll shkrimi i stërgjatë për jetën e Sami Frashërit dhe duhet të kujtojmë se autori Hikmet Feriun Es dhe Kujtim Nuro, ky i fundit që e përktheu dhe përshtati, na treguan edhe pse familja e tij nuk donte që eshtrat e tij të riktheheshin në Shqipëri. Për fat të keq, një varr ka mbetur bosh.

Sui Gragjevi, kritiku i njohur, bashkëpunëtor i përhershëm i "Milosao" na shpjegoi dy performanca aktuale mbajtur më 11 dhe më 12 Janar të sezonit operistik 2018-19 të operës "Aida" dhe të operës "Karmen" në Metropolitan Opera, që sipas tij duhet të vlerësohen për organizimin më të lartë të muzikës klasike, me një *brandësi fantastike dhe një sistem zëri superior*. Për hir të së vërtetës, shkrimi është botuar me vonesë...

Poeti Demir Gjergji erdhi në këtë numër me një cikël poetik me titull "Pjergulla në kupë". Cikli i mëposhtëm, që botohet në përcjellje të kësaj ngjarjeje, është përzgjedhur nga krijimtaria e fundit e autorit. Besnik i stilit të vet, poeti vazhdon synimet dhe përpjekjet e tij drejt formës moderne, të ndërthurur natyrshëm me atë tradicionale, në gjykimin e tij...

Dy shkrimtarë shqiptarë, Luljeta Lleshanaku dhe Ndrek Gjini kanë qenë sivist të ftuar në njërin nga festivala më në zë të letërsisë në Irlandë, Cuirt International Festival of Literature - (8-14 Prill 2019) Ky festival letërsie zhvillohet çdo vit në Galway, qytet turistik në perëndim të Irlandës. Ai është themeluar në vitin 1985 dhe për 34 vjet me radhë ka pritur mjaft shkrimtarë të njohur nga gjithë bota, përfshirë këtu edhe fitues të Çmimit "Nobel", të tillë si Seamus Heaney, Herta Müller e mjaft të tjerë...Këtu patëm një vërejtje nga Agron Albali me të drejtë pasi nuk vendosëm dhe emnin e përkthyeses së Lulit, një vërejtje që redaktori e konsideroi si me shumë vend. Në përgjithësi mund të themi se ishte një numër relativisht i mirë dhe i paqtë.

Kë ka nënë?  
Cilin ka baba?  
Kush e solli në jetë?

E sollën apo erdhi vetë?  
\*\*\*

Po krishti  
Pse ka dy baballarë  
Dhe vetëm një nënë?  
Zoti

Apo Jozefi  
Është babai?  
Përgjigju hyjnisht, zonja Mari!  
Ndryshe të quajta putanë!  
Ndryshe të quajta rospi...  
Po Muhamedi?  
Bir njeriu,

Ka nënë dhe baba?  
Ndeshet përjetësisht me shejtanin,  
S'mund ta lerë të qetë Djallin.  
\*\*\*

Po të vdekurit  
Varret ç'i bënë?  
Toka i mbajti të vdekurit, varret.  
Të vdekurit, - kronikanë të vdekjes,  
Varret

Bunkerë të jetës.  
Djalli, - mbret i mbretërisë së vdekjes.  
\*\*\*

Po erërat tufanet, stuhitë, vetëtimat, rrufetë,  
bubullimat?  
S'ka në kozmos vetëtimat, erëra, stuhi, sh-trëngatë.  
S'ka rrufe, bubullima, tufane, re!  
S'ka poshtë-lart...

Paqja  
Kozmikja. Paqe  
Absolutisht absolute.  
Po relativiteti i Ajnshtajnit?  
Relativitet ka vetëm toka?  
Edhe Ajnshtajni është relativ?  
Në Kozmos absolutja, - absolutisht absolute!  
Absolute paqja dhe lëvizja!  
Kozmosi pa relativitet  
Absolutisht e saktë.  
Absolutisht e vërtetë!  
\*\*\*

Po luftërat?  
Kozmosi nuk njej grindje,  
Kontradikta,

Luftëra, beteja.  
Kozmikët nuk kanë prona, sinorë, kufij;  
Kozmiku, - pronar i gjithësisë!  
Zoti uishte një i vetëm dikur.  
Me kë të luftonte?

Kush do t'ia pushtonte kozmosin,  
Kush do t'ia rrëmbente planetët,  
Yjet diejt?  
Kozmosi, -  
Pronë e njerëzimit që u bë zot.  
Kozmosi, pronë e patrashëgueshme!  
Zoti dhe njerëzimi zot.  
Të dy të përjetshmit  
S'kanë trashëgimira.  
Të përjetshmit trashëgim lenë përjetësinë.  
S'është nevojja. trashëgimira trashëgojnë tokësorët,  
Të vdekshmit,  
Jo qiellorët.  
\*\*\*

Kozmosi s'ka  
Stuhira, rrufe, vetëtimat, erëra, bubullima,  
Qiejt janë vetë qetësia.  
S'pranojnë zhurma.  
Rrufeja s'ka kë të vrasë:  
Të përjetshmit nuk vriten.  
Bimëve,  
Si të përjetshme që janë,  
S'kanë nevojë për shi.  
Vetëtimat  
S'e djeg dot lirin,  
Pyllin e përjetshëm.  
Të përjetshmit nuk digjen kurrësesi.

Në kozmos s'ka Shira,  
Përmytje.  
Blerimi bleron përjetësisht.  
S'ka nevojë për shira, për vesë.  
Blerimi përjetësi e blertë.  
\*\*\*

Bari as rritet, as thahet,  
As korret,  
As hahet.  
Është perëndi e blertë.  
S'e prek asnjë lopë,  
As një dele s'e prek.  
Kozmosi s'ka ajër:  
Shpendët s'fluturojnë.  
Qëndrojnë krahëhapur.  
Pluskojnë.  
\*\*\*

Ku ka ajër, ka asfiksi.  
Ku ka asfiksi ka prapë vdekje  
Ku ka ujë  
Ka etje.  
Ku ka bukë, ka uri,  
Ku ka uri, ka vdekje.  
Ka ndotje, ka qelbje,  
Ka kufoma.  
Ku ka kufoma  
S'ka përjetësi.  
Mes ndoturinave s'jetohej.  
Qiejt kozmikë janë të kulluar  
Kanë vetëm yje, diej, kaltërsi.  
\*\*\*

Yjet,  
Diejt,  
S'marrin frymë.  
Nuk hanë, nuk pijnë.  
Jetojnë me dritë,  
Ushqejnë hapësirat me rreze përjetësisht.

Drita s'kalbet, s'qelbet, s'bie erë, s'infekton.

Rrezet s'këputen.  
Kozmosi  
S'ka plagë,  
S'ka grip,  
S'e zënë ethet, malaria, sida, rrufa.  
Qiejve s'ka prostituta, shtëpi publike.  
Kozmosi,  
Qiejt kozmikë  
Pastrojnë papastërtitë.  
\*\*\*

Kozmosi  
S'kollitet nga tuberkulozi,  
S'ka kriminelë, kanibalë,  
S'ka hajdutë me maska të zeza,  
S'ka të korruptuar të klasit të parë.  
Kozmosi  
Ka engjëj qiellorë,  
Ka ujgër dhe qengia-engjëj,  
Peshk të madh dhe peshk të vogël-engjëjll,  
Ka zot dhe njerëz-perëndi.  
Kozmosi  
I populluar me zota, diej, yje, planetë.  
Kozmosi me përjetësira të përjetshme.  
Në territorin kozmik  
Vdekja vdes.  
Dashuria ngjitet në kozmos.  
Dashuria kozmike,  
Dashuri eterne,  
Dashuri Platonike.  
Dashuri pa puthje,  
Pa takime, pa seks,  
Pa lindje fëmijësh  
Dashuri e përjetshme plot jetë ...  
\*\*\*

Zoti  
Ishte njëjës, domethënë, cilësi.  
Me t'u bërë dhe njerëzimi Zot,  
Zoti u bë shumësi, sasi.  
Nga një i vetëm, dikur,  
Zoti u bë Zot shumësi, një zhgan me perëndi!  
Po Krishti?  
Kozmosi u mbush me Jezus.  
Çdo zot-njeri ka birin e vet.  
Çdo baba  
Ka birin e tij.  
Qielli u ndot?  
Toka u pastrua?  
Pulat po ndotin me glasa yjet?  
Delet po ndotin kaltërsitë me kakërdhi?  
Gjallesat kozmike  
Fitojnë përjetësinë.  
Bëhen Zota  
Dhe zotat s'e ndotin gjithësinë.  
\*\*\*

Zot xheloz!  
Ç'është kjo xheloz!  
Si kështu Zoti, zot?  
Ti po zbrer në tokë?  
S'e duron dot veten turmë, sasi?  
Gëzohu, Zot që nga njëjës, u bëre shumësi,  
Që çdo yll ka zotin e tij!  
Vetëm  
Djalli  
Mbeti vetëm.  
Njëjës ishte dhe njëjës mbeti.  
S'është vetëm opozitari yt,  
Me të gjithë zotat e qiejve  
Është në opozitë...  
Zoti Xheloz.

Me Jezusin për dore po zbrer në tokë?  
Djalli i vetmuar  
Po ngjitet kozmosit, përjetë?  
Zoti u bë djall dhe djalli u bë zot vërtetë?!



A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Shqipëria e viteve post '90 është një vend, i cili po jeton një tranzicion të gjatë dhe të pafundmë. Që nga ai politik me formacionet që ende nuk po vetëdijësohen për misionin e tyre të madh për të drejtuar jetën e vendit; me mungesën e madhe të vetëdijës sociale për stadin e ri; për gjendjen ekonomike e cila ende nuk po e përfaton iniciativën e lirë dhe nuk po shkon në udhën e duhur të ekonomisë së tregut.

Kultura, që i përgjigjet këtij konfiguracioni, ende nuk po na ndihmon për të hedhur dritë në këtë tranzicion. Kurse arti kombëtar më shumë punon të lexohet dhe të vlerësohet jashtë vendit dhe është i mbushur me klishe. Shqiptarët hajdutë, kriminelë, politikanë mashtrues, trafikanti i femrave, përndjekja, hakmarrja që nuk ndalet, stereotipi i lodhshëm i Virgjëreshave, Sigurimsat spiuna, e kështu me radhë, mbushin që në faqet e para ose janë në planet e para. Në ato pak filma ku mund të lexohet një mesazh ndryshe, ai mbytet nga elementët e tjerë të veprës, që patjetër duhet të ketë si kanon këto që parashtruan më sipër.

Duket sikur Shqipëria ka jetuar në një tunel të errët pa asnjë lloj shprese, që pas një drite të be-


Shqipëria ende nuk ka një film të tregojë jetën e dytë nën Komunizëm nën presionin e Sigurimit dhe nën përkorjen absurde, njerëzit që shpëtuan prej saj dhe solidaritetin mes komunitetit; Shqipëria ende nuk ka një film ku mund të tregojë realisht tranzicionin, ashtu si nuk ka një film të mirëqenë të problemeve tona sociale, pa e mbushur dot me klishe. Ne, shqiptarët, ende nuk kemi një film të sinqertë për braktisjen e vendit. Ashtu, si shqiptarët ende nuk kanë një film për përplasjen e brezave...në çdo kohë

## Pse është kaq e vështirë të bësh një film për Shqipërinë e vërtetë?!

të në fillim të viteve '90, është rifutur në një tunel të pafundmë. Njerëzit e artit, sidomos ata të kinematografisë, që përbën një art i cili impaktin e ka shumë të madh në publik e kanë të vështirë të tregojnë një situatë normale ku të mos gjykohej apriori sistemi, por kushtet dhe realitet që i pjellin dhe i mbajnë këto sisteme.

Ka deri barcaleta tashmë për të rinjtë sesi pyesin nëse ekzistonte jeta sociale apo jo në Socializëm, ashtu si sot, një grup gjithnjë e më i vogël militantësh dhe ithtarësh të rrëgjimit të shkuar nxijnë arrijtjet e ditëve tona.

Shqipëria jonë ka bërë një hap normal por me vonesat e veta në çdo periudhë historike. Inercia e saj, ashtu si e shumë vendeve të tjera, ka përcaktuar realitet dhe të ardhmen e vendit. Fatkeqësisht inercia e Shqipërisë ka qenë e madhe. Republika dhe Monarkia e viteve mes Dy Luftërave Botërore, që nuk mundi megjithë përpjekjet



të ndjekë trendin e zhvillimit ekonomik të kohës, Inercia komuniste staliniste e vendit që e la me dekada pas, ashtu si rrruga e viteve '80 e izoloi vendin në një situatë gati absurde dhe drejt një krize ekonomike të frikshme. Nëse do të besonim dhe do të shprehonim se gjendja do të ndryshonte menjëherë pas viteve '90, kjo lë ende vend për t'u sqaruar por shumë nga elementët kanë mbetur në vend, brenda këtij sistemi të ri. Arti dhe

kultura nuk kanë mundur të bëhen dot kabanë zgjimi për publikun, kurse tashmë libri spekulues dhe filmat që më shumë bëhen për jashtë as nuk ngjallin më kërshëri të publiku ynë. Edhe një pjesë që mbartin vlera të humori i zi për shkak të gjetjeve natyrale, janë më shumë përshkrues groteskesh sesa realisht simboli i Shqipërisë së asaj apo kësaj kohe.

Shqipëria ende nuk ka një film të tregojë jetën e dytë nën Komu-

nizëm nën presionin e Sigurimit dhe nën përkorjen absurde, njerëzit që shpëtuan prej saj dhe solidaritetin mes komunitetit; Shqipëria ende nuk ka një film ku mund të tregojë realisht tranzicionin, ashtu si nuk ka një film të mirëqenë të problemeve tona sociale, pa e mbushur dot me klishe. Ne, shqiptarët, ende nuk kemi një film të sinqertë për braktisjen e vendit. Ashtu, si shqiptarët ende nuk kanë një film për përplasjen e brezave...në çdo kohë.

Mungojnë gjetjet? Mungon fondet? Të gjitha bashkë. Në fakt, mungon përgatitja që Shqipërisë t'i dhurohet një film sepse shqiptarët e kanë vështirë të shohin realisht historinë e tyre pa doreza. Pa frikë. Pa droje. Hapur. Shqiptarët nuk e dinë se çfarë të shkruajnë për shqiptarët, sepse kanë mbetur një popull virtual. I etur të dëgjojë dhe të shikojë fillimisht gjykimin e të huajve. Kjo, realisht, duhet të na dhembë. (Milosao)

Ky është një material i panjohur për Aleksandër Moisiun, që na ofrohet nga një njohës i mirë i kulturës polake, Leonard Zissi

## ALEKSANDËR MOISIU NË VLERËSIMIN E KRITIKËS POLAKE

Më 23 mars të këtij viti u mbushën 84 vjet nga vdekja e Artistit të Madh me famë Botërore me origjinë shqiptare, Aleksandër Moisiu. Si aktor në Teatrin Gjerman të Berlinit, ai ka bërë një sërë turnesh në vende të ndryshme të Europës, ndërmjet të tjerave edhe në Poloni, i ftuar nga Teatrot polake. Në vitin 1925 ai dha shfaqje në Varshavë, në vitin 1926 në Krakov dhe Lvov ("Hamleti" dhe "Mbreti Edip") dhe në vitin 1928 përsëri në Krakov ("Fausti"). Për vlerësimet e larta që i ka bërë kritika polake e asaj kohe, po botojmë artikullin e shkruar në revistën polake "Zycie Teatru" ("Jeta e Teatrit"), Nr 44-45, datë 01.11. 1925. Ky atikull është shkruar pas shfaqjes që Moisiu dha në Varshavë në vitin 1925, e cila nuk ishte shfaqje teatre, por një recital me interpretime nga pjesë të ndryshme të autorëve më në zë të kohës. Artikulli shoqërohet me dy fotografi të Moisiut në rollin e Hamletit dhe në atë të Potasovit.

Dihet se Aleksandër Moisiu në ato vite udhëtoi me pasaportë italiane, prandaj për këtë arsye në botë njihet si aktor italian, siç përmendet edhe në këtë artikull, pa i përmendur origjinën familie shqiptare të tij.

## ALEKSANDËR MOISIU

Hajnit), megjithatë duhet pranuar se Moisiu zërin e përdor gjithmonë ashtu siç e dëshiron ai vetë dhe se ky zëri nuk e zhgënjën atë asnjëherë.

Për realizimin e këtij qëllimi, Moisiun e ndihmon shkalla e lartë e fuqisë së zërit. Me të vërtetë Moisiu ka të drejtë të thotë për veten e vet se është Caruso i deklamimit. Deklamimi i tij nuk mbështetet në një ose dy tone, vetëm në rast e këtë e kërkon karakteri i interpretimit të veprës. Si rregull, Moisiu është në gjendje të përdorë të gjithë diapazonin e zërit të tij.

Diksioni i Moisiut është



shembullor. Çdo fjalë ka formën e saj plastike. Këtu tërheq vëmendjen shqiptimi i jashtëzakonshëm

që qëndron shumë lart i fjalës "Tot" [në gjermanisht "I vdekur"], në të cilën secila gërmë formoi një tingull të veçantë dhe prej këtyre tingujve të veçantë u formua tritëngulli harmonik. Përveç kësaj, shqiptimi i Moisiut bëhet sipas rregullave të caktuara në Gjermani. Pra ai, p.sh. nuk thotë "K'nig" [Mbreti], por "K'nich"; nuk thotë "Wahnsinnig" [I marrë], por "Wahnisinnich". Shkronjën "R" Moisiu e shqipton në mënyrë të rregullt, megjithatë, gjatë interpretimit të shpejtë, kjo "R" nuk dëgjohej. Ndoshta kjo është mangësia e vetme e vogël e diksionit të këtij mjesh-

tri të fjalës.

Deklamimi i Moisiut i mbështetur në diapazonin e gjërë të zërit dhe në mosdeformimin e diksionit, shpesh herë kalon në transformimin në një farë lloji të këngës. Ky është deklamimi që buron nga shpirti i muzikës. Pra, ky është deklamimi i vërtetë dhe jo leximi i rreshtit të prozës. Një mjeshteri kaq të kapshme të deklamimit, në Gjermani Moisiun e ka arritur vetëm një aktor, Jozef Kainz, për të cilin Adolf Winds, me të drejtë ka shkruar: "Kainz simfoninë e lexon".

Megjithatë, recitimet e Moisiut nuk kanë qenë pa pretendime. Temperamenti i tij u ngrit lart kur deklamoi "Dy granadierët" që përmendëm më sipër. Moisiu i hoqi vepërës së Heinit vetëm një element të sentimentit ushtarak, duke e bërë atë, ashtu siç konstatoi me të drejtë Irzykowski, një farë këngë hakmarrëse. Por këtë mospërpunje me frymën e vepërës, recitimin e bëri plotësisht të nxehtë interpretimi kryevepër, fisionik dhe realist, siç ishte deklamimi i "Eres së Nëntorit" dhe i "Dëborës" së Verhaerenit. Çdo fjalë, çdo rrokje transmetuan këtu misterin e atmosferës së vepërës. Fjala gëndroi këtu në kufirin e poezisë dhe muzikës.

Dhe për këtë arsye, megjithëse patëm mundësinë të admironim në Varshavë një pjesëzë të vogël të këtij aktori të madh, kjo pjesëzë e vogël qëndroi në nivele kaq të larta, sa që nuk do ta harrojmë shpejt këtë gosti që na dha Moisiu në Poloni.

\*Përgatiti Leonard Zissi

## IN MEMORIAM

NGA WIKTOR BRUMER\*

Moisiu, që javën e kaluar magjepsi publikun varshavian me recitimin e tij mjeshteror, do të thojë se është vetëm një pjesëzë e vogël e një aktori të madh që, prej shumë vitesh, krahas Bassermanit, përbëjnë themelet e teatrit reinhardtian.

Një pjesëzë e vogël e Moisiut, ka qenë edhe si aktor filmi. Shitje më gjithashtu: aktor i mrekullueshëm, i cili me shkëlqimin e syve, elektrizoi publikun.

Moisiu i vërtetë në vetvete është bashkimi i fjalës me gjestin, ndërkohë që ruan plotësisht në maksimum ekuilibrin midis këtyre dy elementeve, megjithë gjallërinë e talentit të vet dhe temperamentit të tij italian. Megjithatë, shfaqja e Moisiut në Varshavë vetëm në karakterin e recituesit, zgjoi një interesim të kuptueshëm dhe tërheqje vëmendjen për një karakteristike shumë të rëndësishme të talentit të Moisiut.

Pra, Moisiu jo vetë ka një organizim të përsosur zanor, por ai di ta zotërojë zërin e tij. Nuk mund të pranojmë gjithmonë drejtësinë e përdorimit të dinamikës së zërit të Moisiut në një krijimtari të caktuar (p.sh. në "Dy granadierët" e

Opinioni **i** Ditës

# "Shtet i ri" si përlligjje e shtetit tribal

Nga Lis Bukuroca

(vijon nga faqja 1)

... përlligjur punësimin e nipave, mbesave, të reja dhe kushërinjve, të bijve dhe bijave, shpeshherë përsëritet konstatimi i njëjtë "jemi shtet i ri!". Kjo domethënë "kini durim me injorancën tonë"! Me atë pohim, ata mendojnë të shëlbohen nga të gjitha mëkatet, të rehabilitohen nga të gjitha abuzimet dhe nga të gjitha shpërdorimet, që i bëjnë për interesa të veta, por në vazhdimësi, duke dëmtuar shteti dhe duke defaktorizuar atë.

E vërtetë se Kosova është shtet i ri; pak më i ri se Maqedonia, pak më i ri se Mali i Zi, se Kroacia e Sllovenia, por shtetin e ri nuk e udhëheqin fëmijët. E vërtetë se Kosova është njëmbëdhjetëvjeçare, por jo politikanët e saj! E vërtetë se shteti nuk ka arritur moshën e pjekurisë, mirëpo Kosova nuk është një fëmijë. Nëse marrim vitet e shtetit si arsyesitimi të keqpërdorimeve, atëherë krejtëllta politike duhet të jetë nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, çfarë nuk janë! Edhe ky është fakt! E pastaj, mosha e shteti nuk është tregues kryesor për suksesin. Shtete me traditë të madhe janë shembur kur janë kapur nga kriminelët! Shteti nuk shembet vetëm nga një sulm i jashtëm, por realizohet në mënyrë më efektive, edhe pse më ngadalë, kur njerëzit që udhëheqin nuk njohin vlera morale, kurse prokuroritë dhe gjykatat janë plebenjtë e tyre.

E si është e mundur që shteti paska moshë miturie, kurse politikanët, që e udhëheqin, të gjithë janë të moshës madhore!? Ose, pse ata kërkojnë të trajtohen si të mitur dhe përvetësojnë për vete moshën e shtetit, kur vetë janë disa herë më të moshuar se shteti?! Sepse u nevojitet koha! Koha për t'i përmbyshur planet e veta.

Në epokën e Jugosllavisë nuk ishin fare shtet, por që nga kopshiti i fëmijëve, nëpër universitete, deri në akademi, kishim institucione dhe administratë më funksionale, më serioze, më të përgatitur profesionalisht dhe jo gati tërësisht fisnore, si sot, ku rol vendimtar nuk luan aftësimi profesional, por afria fisnore!

Në qoftë se pranojmë si të saktë, si të drejtë pohimin e tyre të shumë përsëritur, atëherë theksojmë se para shpalljes së pavarësisë, nuk njihim institucione shtetërore, nuk kishim pasur kurrë administratë dhe nuk kishim asnjë përvojë. Domethënë ishim një tufë njerëzish, që sapo kishte zbritur nga malet, së cilës i kishte shkrepur në mendje ndërtimi i një shteti!

Në fakt, arsyesitimi "shtet i ri" shërben për të përlligjur arbitraritetin, shtetin fisnor, inap-



tokracinë, kleptokracinë, nepotizmin, padijen e madhe, oportunizmin dhe natyrisht për të fituar kohë për karrierë, për pasurim dhe për të këndellur fisin.

Ata që udhëheqin, paguhen për të përmirësuar mirëqenien e popullit, jo për ta keqësuar atë! Ata deri tani kanë korrigjuar standardin e jetës së vet dhe të të afërmeve, por jo të njerëzve jashtë klaneve të veta! Sukses më të madh ata do të llogarisnin heqjen e vizave dhe mundësimin e zbrazjes së vendit! Këtë e ndjekim me zjarrmi në përgatitje e sipër për të sekuestruar meritat!

Shkurt e qartë, edhe pse jemi shtet i ri, kemi shumë njerëz të aftë, por jo aty ku duhet. Kosova me shpalljen e pavarësisë nuk ktheu popullin kolektivisht në gjendje miturie. Gjersa ata me vetëdije, ose dije të të miturve

udhëheqin shtetin, atëherë arsyesitimi se jemi shtet i ri, qëndron! Në aspektin intelektual shumë prej atyre që udhëheqin sot shtetin, janë në gjendje miturie dhe vazhdimisht ndjejnë nevojë për tutorë, ose për një mori këshilltarësh!

Ata mund t'u shkruajnë fjalime, mund të përgjigjen në vend të tyre nëpër intervista me shkrim, por kur ata shfaqen para publikut, shndërrohen në personazhe për gazmore, si dikur Iljaz Kurtesh e Ali Shukria! Aty edhe njëmijë këshilltarë nuk mund të ndihmojnë!

Pse ndodhi kjo? Dikur në Jugosllavi shqiptarët ndaheshin në të ndershëm dhe në nacionalistë-irredentistë. Shqiptarët e ndershëm ishin të përshatshëm për pozitë të rëndësishme. Pikërisht në këtë mënyrë është vepruar edhe

pas çlirimit: LDK ka marrë parasysh përshatshmërinë partiake, PDK gjithashtu, tani i ka ardhur në kuti një zogorie partish. Një koalicion kope, që nuk besohet se mund të mbijetonte disa javë, me rritjen e pagave, u përforcua! Asnjë nga qindra ministra e zëvendës nuk do të prishin këtë maskaradë politike.

Fakti se kanë pasur fytyrë të marrin ato poste duke ditur se po krijojnë qeverinë më të madhe në planetin Tokë, tregon pa keqkuptime synimet e tyre, por edhe për integritetin moral, që për fat të keq, nuk e kanë. Çfarë duhet bërë Kosova në këtë gjendje? Duhet t'i jepet mundësia Albin Kurtit, përndryshe Serbia do ta rifitojë Kosovën të zbrazët nga shqiptarët!

Aty ku nuk ka shtet të së drejtës, njerëzit as nuk janë të lumtur, as nuk duan të mbeten!

## HOROSKOPI

### DASHI

Ka gjasa të përballeni me probleme financiare, ndaj tregoni shumë kujdes me shpenzimet gjatë ditës. Do të ishte mirë nëse këtë të diel fokusoheni në gëshje që janë të qarta dhe të kuptueshme. Kohën e lirë do ta kaloni duke kryer aktivite që do ju falin kënaqësi pamase.

### DEMI

Kjo e diel premtan të kalojë mjaft mirë. Lista e gjërave ndaj të cilave do t'ju duhet të kujdeseni sot nuk do të jetë e gjatë. Rekomandohet ta kaloni kohën larg çdo problemi dhe të përqipeni të shmagngi ndonjë zakon të keq të mundshëm.

### BINJAKET

Binjakët nuk do të kuptohen plotësisht me të afërmit. Ndoshta ata nuk do të jenë në gjendje të kuptojnë idetë tuaja aventureske dhe nuk do t'i mbështesin planet për ndryshim. Vepromi ashtu siç mendoni se është më mirë dhe mos rezikoni me paratë.

### GAFORJA

Gaforret do të bëjnë hapa drejt ëndrrës së tyre. Mund të arrini rezultate të paprecendenta. Duhet t'i kushtoni më shumë kohë vetes, por edhe familjarëve. Shmagngi projektet që duken absurde, pasi do të jetë kohë e humbur për ju.

### LUANI

Luanët duhet të jenë më të vëmendshëm ndaj aktiviteteve sot. Bani kujdes, pasi gjatë ditës mund të dëmtoheni fizikisht. Ndaj, për këtë arsye shmagngi sportet, punët e lodhshme fizike apo udhëtimet e gjata.

### VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje do të jenë të kënaqur nga rezultatet e kësaj dite. Do të keni sukses në marrëdhëniet personale, por do të ishte e udhës të mos u imponoheni bashkëbiseduesve. Ekziston mundësia që gjatë një eventit të lumtur të shmagngi një problem serioz.

### PESHORJA

Peshoret mund të mësojnë një sekret shumë të rëndësishëm për jetën e dikujt tjetër. Rekomandohet të mos e diskutoni një gjë të tillë as me miqtë më të ngushtë. Pjesa tjetër e ditës parashikohet të jetë monotone. Nëse kërkoni ndryshim në jetën tuaj, nuk është ende e mundur.

### AKREPI

Do ta keni mjaft të vështirë të merreni me punë sot. Ndoshta nuk do të ndiheni në formë për të qenë aktivë gjatë ditës. Udhëtimet janë të mirëpritura. Sa i përket marrëdhënies suaj romantike, është dita e duhur për të bërë deklarata dashurie.

### SHIGJETARI

Nuk do të mund të pushoni ashtu sikurse dëshironi. Ka gjasa të përballeni me një sërë problemesh. Mund të debatoni me një prej familjarëve tuaj, megjithatë gjithçka do të kalojë shpejt. Kufizoni kohën e qëndrimit nëpër rrjete sociale.

### BRICJAPI

Do të jeni të mbushur me pozitivitet. Është dita e duhur për njëjtë reja, takime miqësore, komunikim romantik apo aktivitete kreative. Mund të vizitoni një të afërm të largët, ose të realizoni një udhëtim të shkurtër.

### UJORI

Disa Ujorë do të kenë shansin të marrin disa kontraktë të dobishme, që të do të jenë mjaft të nevojshme në marrëdhëniet profesionale. Sa i përket marrëdhënies suaj romantike, do të ndërmerrni një hap të rëndësishëm. Besarëte kësaj shenje duhet të mendojnë një model të ri shenjeje ndaj seksit të kundërt.

### PESHQIT

Kjo ditë do të jetë e përshatshme për ju që të zgjidhni disa probleme, të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë. Duhet të luftoni për të pasur më shumë vëmendje nga partneri/partnerja juaj. Ata që dëshirojnë të rinë nën hije, rekomandohet të mbledhin më shumë informacion.

Opinion i Ditës

# Sistemi, fajtori "fake" i krizës!

Nga Lutfi Dervishi

(vijon nga faqja 1)

... shkaktarin e të gjitha këqijave mund të krahasohet vetëm me momentin Eureka të Arkimedit.

Politikanë të vjetër dhe rishtarë në politikë, analistë dhe kuështarë të pandreqshëm, rrjete organizatash joqeveritare dhe rrjetet sociale janë mbushur me parullën "Të ndryshojmë sistemin" (zgjedhor). Kjo parullë e re po paraqitet edhe si shpjegim se pse e tundim prej 30 vitesh parullën "E duam Shqipërinë si gjithë Europa".

Opozita e "vjetër" dhe sidomos ajo e "re" me flamurin e ndryshimit të sistemit kërkojnë të prijnë përpara drejt një sistemi, ku populli do ta këtë në dorë të zgjedhë deputetët dhe jo kryetarët e partive.

Sistemi zgjedhor i ndryshuar në vitin 2008, proporcional rajonal, u bë me konsensus të gjerë dhe me premtimin se vendi do të kishte parlamentin elitar! Në dorë të 3-4 kryetarëve të partive u la zgjedhja e "elitës".

Askush nuk ndalet të përgjegjësitë individuale të 3-4 kryetarëve të partive, që e mbushën Kuvendin me elitën që e nxori jashtë dekriminalizimi. Në vend që të flitet për ndryshimin e kryetarëve që bënë këtë gjëmë - e kemi më të thjeshtë të kërkojmë ndryshimin e sistemit!

Sistemi, (zgjedhor) që duam të ndryshojmë garanton që edhe PD, edhe PS të përfaqësohen me deputetë në çdo qark të Shqipërisë. Sistemi mënjanoi rrezikun e ndarjes politike veri-jug, (ku psh., PS rrezikon të mos marrë deputet në Shkodër dhe PD në Vlorë).



Sistemi garanton përfaqësimin më të madh të grave në politikë. Dhe kurrë në historinë parlamentare nuk ka pasur më shumë gra dhe vajza në Kuvend. Është shumë interesant të dëgjosh deputete gra që kërkojnë ndryshimin e sistemit,

që jep garancitë më të mira për përfaqësimin e tyre.

Sistemi proporcional rajonal garanton një lidhje më të mirë të pushtetit vendor me pushtetin qendror. (Votuesit kërkojnë deputetët nga qarku i tyre dhe nuk

pëlqejnë deputetët turistë).

Sistemi garanton stabilitet qeverisës dhe zvogëlon në maksimum mundësinë për kriza politike. Jo. Nuk duam "stabilokraci", duam kriza se përmes krizash garantojmë që humbësi asnjëherë nuk

jep dorëheqje dhe fituesi nuk e mendon kurrë jetën në opozitë. Nuk është faji i sistemit as për korupsionin dhe as për keqqeverisjen!

Sistemi (zgjedhor) në 2008-ën u ndryshua nga frika e individëve me xhepa të thellë dhe muskuj të fortë. A mos vallë ligji ka qepur xhepat e këtyre tipave dhe institucionet janë bërë aq të forta sa muskujt e "muskjetjerëve" janë fishkur?!

Si zgjidhje ideale kundër sistemit aktual përmenden listat e hapura. Kjo zgjidhje garanton që hapjen kutive nuk do ta kërkojë më kundërshtari, por shoku/shoqja e partisë.

A është faji i sistemit zgjedhor që partitë politike janë kthyer në parti sulltanësh?!

A është faji i sistemit zgjedhor që partitë politike nuk respektojnë nenin 9 të Kushtetutës për transparencën financiare?

A është faji i sistemit zgjedhor që partitë janë kthyer në institucionet më të fuqishme dhe më të papërgjegjshme para ligjit?

Nëse është faji i sistemit, hajde ta kryqëzojmë.

Një proverb thotë: "Ruaju nga ajo që dëshiron!"

Para se të këndojmë në kor këngën e ndryshimit të sistemit, duhet të mendojmë kë të fajësojmë më pas kur të biem nga shiu në breshër?!

Rrënjët, degët, frutat dhe zgjidhja e krizës duhen kërkuar të shkaqet dhe të shkaktarët!

Nëse nuk ndalim vrapin që kemi nisur, do të rrezikojmë që shumë shpejt të ngremë gishtin e akuzës ndaj atyre që sot kërkojnë ndryshimin e sistemit.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.


MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- 1. Eshhtë babëzia.
- 8. Burton regjisor.
- 11. Skllavja e Abrahamit.
- 12. Një dite në mbledhje.
- 14. Tyson i boksit.
- 15. Rrethojnë ringun.
- 17. Beson pa kufij.
- 19. Zola që shkroi Nana.
- 20. Eshhtë ankimim.
- 23. Pak elementare.
- 24. Janë me para në bankë.
- 26. Matet pa kufij.
- 27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
- 28. Një zog i verdhë.
- 29. Inicialet e Moravia-s.
- 31. Qytet gjerman.
- 34. Një zonjë që ha gurë.
- 35. Pak analogji.
- 36. I ka plasur të paturpit.

- 37. Janë legjendat.
- 38. Nuk ka akoma një bebe.
- 39. Fillojnë mirë.
- 40. Janë brinjë në skuadër.
- 42. Shkruhet i shtati.
- 44. Nget edhe ajo e mirë
- 47. Mbahet në gisht.
- 48. Janë numrat 1, 3, 3...

**VERTIKAL**

- 1. Kanë shpate të tilla.
- 2. Janë edhe ato polare.
- 3. Janë mizorët.
- 4. Janë male në Rusi të tilla
- 5. Eshhtë nusja me vello.
- 6. Një rreth pa ekstreme.
- 7. Mbyllin kuvendin.
- 8. Në kryr të titujve
- 9. Diku në qendër.
- 10. Markë cigaresh.
- 13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
- 14. Janë penjtë për gjergjef.
- 16. Mbarojnë fare.
- 18. Janë stitët e... provimëveve.
- 20. Mund të jenë fotografikë të tillë.

- 21. Vitet pa kufij.
- 22. Një fjalë për tutje.
- 24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- 25. Eshhtë e akuzuara... injorante
- 26. Baldwin aktor
- 27. Një pjesë e kandidatëve.
- 28. Krenar pa çift.
- 30. Grazia Cucinotta.
- 32. Paul këngëtar.
- 33. Janë pëshiellat.
- 35. Inicialet e Moravia-s.
- 37. Pak makinacione.
- 38. Samuel bomber kamerunas.
- 40. Markë makine koreane.
- 41. Ente Kombëtare Durrës.
- 42. Fillojnë kurat.
- 43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
- 45. Ekstreme në litrar.
- 46. Fillojnë lejen.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- 1. Sateliti i Uranit.
- 6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
- 11. Tiran pa kufij
- 12. Në krye të armatës.
- 13. Një Ibrahim violinist.
- 14. Qendër ditore.
- 15. Mund të jenë fotografikë.
- 17. Inicialet e Einstein.
- 18. Një mbishkrim në kryq.
- 20. Janë si vite.
- 21. Thurman aktore.
- 22. Të parat në irritim.
- 23. I preu Seneka.
- 25. Fillojnë ilustrimet
- 26. Isaac Asimov.
- 27. Një Vladimir kompozitor.
- 28. Janë në modë.
- 30. Janë zyrat... qeveritare
- 32. Me të nxjerrin trarë.


- 35. Një shkop, thupër.
- 37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
- 39. U thyen në Salamina.
- 40. Një raport shumë i ngushtë.
- 41. Nota e diapzonit.
- 42. Fund heroi.
- 43. Një top në rrjetë.
- 45. Gysma alarmi.
- 46. Herët pa zë.
- 47. Sampras i tenisit.
- 48. Me to bëjnë triko.
- 49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
- 50. Janë kokrrat e lisit.

**VERTIKAL**


- 1. I famshëm ai i Sizifit.
- 2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
- 3. Fillojnë rastësisht.
- 4. Një pjesë e napolitanëve.
- 5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
- 6. Mund të jenë kundërajrore.
- 7. Lindin në kokë.
- 8. Gjysmë shtegu.
- 9. Hiden të parat.
- 10. Eshhtë njeriu i përsosur.
- 13. Një fjalë për tutje.
- 15. Fundi i një samurai.
- 16. Mbyllen me epilog.
- 17. Bel i maupassant.
- 19. Inicialet e Redford.
- 23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
- 24. Në hyrje të tokës.
- 26. Pak impresioniste.
- 27. Janë metrat në sipërfaqe
- 29. Hapat një për ajër.
- 30. Gjysmë krenar.
- 31. Një hidrokarbur.
- 33. Vrau Hektorin.
- 34. Një film i rixhruar.
- 36. Kupat pa kufij.
- 38. Inicialet e Nolte aktor.
- 41. Ullmann aktore.
- 43. Një brilantinë moderne
- 44. Hotel pa kufij.
- 46. Ekstremë në hall.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A
L	A	N	A	F	E	A	R	I	S			
A	L	N	E	N	A	P	T	O	P			
N	E	G	E	R	S	I	R	A	T	B	I	
I	A	S	M	O	D	E	U	M	I	T	R	
S	A	M	T	A	R	A	F					
M	R	O	N	I	N	A	R	I	E	T		
H	A	B	E	R	I	O	M	A	K	E		
K	R	I	T	S	E	K	I	E				
T	E	M	E	R	E	L	I	N				
O	T	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
M	A	R	I	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	I	E	P	R	M	I	T	E	
T	N	A	T	U	M	A	D	T	E	S		
S	K	I	T	S	E	N	D	E	R	E		
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	A		
T	E	M	K	E	N	D	I	M	I	S		
R	A	F	J	O	E	B	E	L	A			
I	T	A	A	A	N	A	K	I				
O	K	A	N	A	I	S	A	R	N	A		
Z	E	L	L	I	L	I	M	E	D			
T	E	B	A	R	I	T	O	N	T	O	R	
T	O	K	A	A	L	L	E	R	A			
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R	

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

			8	2	4			
1					5			
6			4					
	9		7			1		
			9					
		6				5	3	
		7	2					
5	4							
2	3		6		7			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	3	7	1	4	5	2	8	9
9	1	4	6	2	8	7	5	3
2	8	5	7	3	9	4	1	6
3	4	9	2	1	7	5	6	8
7	2	1	8	5	6	9	3	4
8	5	6	4	9	3	1	2	7
1	7	8	9	6	2	3	4	5
4	6	3	5	7	1	8	9	2
5	9	2	3	8	4	6	7	1

**Argëtim filozofik**

- Gjithçka që kërkohet është një mundësi për të treguar se paratë nuk më bëjnë të lumtur.

- "Çdo ditë ngrihem dhe shikoj listën e "Forbes" për njerëzit më të pasur. Nëse nuk jam atje, shikoj në punë".

- Ka njerëz që shembin me karakterin e tyre, atë që ata ndërtojnë me mendjet e tyre.

**Thënie të mençura**

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	3	U	7	L	2	T	14	4	9	7	4	19			
8	10	5						1	4	12	2	6	7	5	10	
10	4	7						4	1	2	8	10	6	4	7	5
18								1	7	5	8	9	4	2	10	4
6	5	1						6	2	10	5	2	5			12
7	1							17	5		1	5	10	17	4	2
2	5	10	17	4	2			4	10		6	15	5			
8	2	8	12	15				6	10	17	5					
18	10	5	16	19				6	4	8		10	1			
6		7	5					6	11	5		9	19	6	7	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6				
12	5	2	5					12	1	6	15	4	2			8

T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H	
O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E	
G	N	O	T	O	R	E	T	T	M	T	
E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
R	S	L	R	E	T	E	R	E	R	I	K
P	E	L	O	T	A	D	V	M	A		
S	O	T	R	T	A	R	E	E	T		
T	R	G	P	A	R	E	T	E			
E	T	L	A	R	I	T	M	I	A		
F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A	
A	D	I	T	E	T	O	M				
N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E

- Mos kujtoni se nuk ka kafshë, vetëm dhe vetëm sepse pylli është i qetë ..
- "Mos u gënjeni duke besuar se një njeri i pasur është domosdo i zgjuar. Ka mjaft prova që vërtetojnë të kundërtën".
- Eekzistojnë krime më keq se sa të djegësh libra. Një nga këto është të mos i lexosh.
- Sa më shumë i ndershëm njeriu, aq më i keq fati i tij.

